

# Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT  
Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2012

# A KA PËRPLASJE MES BIBLËS DHE SHKENCËS?!

## Si e përshkruanin Shumerët krijimin e njeriut!

(Pjesë nga libri, Planeti i 12- të)

- Pjesa 10 -

Autori, shprehet se:

“libri në fjalë, nuk ka asnjë kundërshtim midis Biblës dhe Evolucionit.

“Libri i qëndron kohës”, thotë autori, dhe “besoj unë, se na tregon të vërtetën për vet zanafillën tonë- dhe që,  
**NE NUK JEMI VETEM.”**

**ZECHARIA SITCHIN**

**Planeti i 12 -të**

**Tiranë, 2009.**

### KRIJIMI I NJERIUT

Hollësitë hetuese të rrëfenjës mund të bartin një të vërtetë të rëndësishme. Është krejt e konceptuese që përpara se t'i ktheheshim krijimit të një qenieje sipas shëmbëlltyrës së tyre, Nefilimet u përpoqën të dilnin me një “shërbëtor të fabrikuar” duke eksperimentuar mundësi të tjera: krijimin e një hibridi kafshë njeri majmun. Disa nga këto krijesa artificiale mund të kenë mbijetura për ca kohe pos sigurisht e kishin të pamundur të riprodhoheshin. Enigma e njerëzve-dem dhe e një rezeve –luan që stolisin qendrat e tempujve në Lindjen e Afërt antike mund të mos kenë qene veç pjellë e imagjinatës së një artisti por krijesa reale që dilnin nga laboratorët biologjikë të Nefolimëve- eksperimente të pa suksesshme përkujtuar në art dhe me statuja.

Tekste Shumere, gjithashtu flasin për njerëz të keq formuar krijuar nga Enki e Perëndesha Nënë, gjatë përpjekjeve të tyre për të formuar një Punëtor të Ulet të përkryer. Një tekst njofton se Ninhursaga, detyra e se cilës ish t i “Bashkonte ngjizjes kallëpin e zotave” u deh dhe “i thirri Enkit” “Sa i mirë ose sa i keq është trupi i njeriut? Siç ma thotë zemra, mund të ia bëj fatin të mirë ose të keq”. Me keqdashje, pastaj sipas këtij teksti- por ndoshta pashmangshmërisht, si pjesë e një procesi provo dhe gabo- Ninhursaga prodhoj një Njeri që s mund ta mbante urinën, një grua që s mund të lindte fëmijë, një qenie që s kish as organe mashkullore as femërore.

Gjithë- gjithë, u sollën në jetë nga Ninhursaga gjashtë njerëzore të keq formuar apo më të mbeta. Enki mbahej përgjegjëse për krijimin e papërsosur të një njeriu më sy të ç rregullt duar që i dridheshin, mëlçi të sëmur, zemër të dobët; një të dytë me sëmundje që shoqërojnë pleqërinë; e kështu me radhë.

Por, më në fund Njeriu i përkryer u realizua- ai që Enki e quajti ADAPA; Bibla, ADAM; studiuesit: HOMO SAPIENS.



Mons. Angelo Massafra URIM	4
KRISHTLINDJA NË HISTORINE E NJEREZIMIT	5
Mons. Angelo Massafra SHQIPËRIA FITOI LIRINË	8
Elvis Çefa LIGJI - DIÇKA E GJALLË	9
Preç Zogaj DREJT EVROPËS	9
EKSPOZOHET MESHARI I GJON BUZUKUT	12
Tomë Mriaj POPUJT E ROBNUEM	14
Andrea Marku JEZUITET E MUZIKA	17
Tonin Çobani MITOLOGJIA NË LAHUTËN E MALCISË	19
Dom Nikë Ukgjini AUSTRO-HUNGARIA DHE KISHA KATOLIKE	24
DITËLINDJA E POETIT MJEDA	31
VITRINA E LIBRIT	32

## KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXVII, nr. 11/12 (446-447) Nëntor - Dhjetor 2012

Revistë  
Fetaro-Kulturore  
Drejtues  
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia  
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)  
Atë Mario Imperatori S.I.  
Dom Gjovalin Sukaj  
Loreta Tomaj

Adresa:  
Arqipeshkvia Shkodër  
Sheshi Gjon Pali II  
Tel. 0222-42764  
Fax. 0222-43673  
e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it  
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



URIME PËR KRISHTLINDJE

NË KËTË KRISHTLINDJE DUA T'A FALËNDEROJ ZOTIN PËR SHQIPËRINË TONË

“Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe” ... kështu Isaia profet paralajmëronte lindjen e Mesisë, Jezusit Shpëtimtar. Në këtë citim biblik më duket se gjendet e vërteta e dashurisë që Zoti ka për njeriun e çdo kohe, por edhe malli dhe nevoja që njeriu i çdo kohe ka për Hyjin. Në këtë frazë biblike populli paraqitet në ecje, pra është duke kërkuar që të arrijë gjëkund apo tek dikush dhe në këtë ecje ai takohet me dritën që i mbulon fytyrat e tyre, ndriçon shqisat dhe njohjen duke mbushur me kuptim të thellë çdo gjë që rrethon popullin në ecje.

Kisha, kjo bashkësi e besimtarëve të Krishtit, është ai popull i ndriçuar që ka takuar dhe udhëhiqet nga Krishti dritë që ndriçon çdo gjë dhe i jep kuptim çdo njeriu. Dhe në këtë, Vit të Fesë jemi thirrur nga Papa Benedikti XVI për të thelluar fenë tonë dhe për qenë më të vetëdijshëm, se nëpërmjet pagëzimit kemi qenë ndriçuar Nga Krishti, drita e Botës. Ju tashmë, të udhëhequr nga Krishti dritë, jeni në ecje drejt atdheut qiellor, drejt Krishtit i cili ju tërheq që të mos shkurreheni rrugës.

Ndërsa, jemi në ecje drejt Qiellit – Mbretërisë së Zotit – ndoshta tronditemi nga lajme të trishtueshme të vrasjeve, vëllavrasjeve, të hakmarrjeve apo të gjakmarrjeve, ndoshta tronditemi nga përdhunime apo sprovhemi nga korrupsioni e dhuna që disa zyrtarë apo njerëz të angazhuar në të ashtuquajturën drejtësi apo në fushat e punëve shoqërore e publike ushtrojnë mbi qytetarët e thjeshtë. Ndoshta shumë – e sidomos ata që janë në zonat malore apo jashtë qyteteve – janë të prekur thellë nga varfëria dhe skamja. Ndoshta pas shkëlqimit të dritave zbukuruese e festave qëndron një varfëri morale, e cila në të vërtetë çon në një varfëri njerëzore etj...!

Prandaj, kemi nevojë për Krishtin dhe dritën e tij, sepse pa Zotin në zemër e në zgjedhjet e jetës nuk mund të bëjmë të mirën. Prandaj, vëllezër e motra, Isaia na nxit që të lartësojmë kryet tonë drejt qiellit e të ndriçohemi nga drita e Krishtit. T'i bëjmë ballë së keqes për të mirën e jetës së përbashkët e që hapat tonë drejt qiellit të jenë plot lumturi në zemër.

Në Krishtlindje, ne kuptojmë se në këtë angazhim për të mirën nuk jemi vetëm. Zoti Jezus është me ne. Ai është rruga, drita dhe ndihma jonë.

Në këtë Krishtlindje dua t'a falënderoj Zotin për

Shqipërinë tonë, dua t'a bekoj Zotin për 100-vjetorin e Pavarësisë dhe për të gjithë ata burra e gra që shkrinë jetën e tyre për Fë e Atdhe.

Në këtë 100-vjetor, ndërsa, festoja dhe gëzoja si të gjithë shqiptarët, për tokën mëmë, ndërkohë, reflektoja, se një popull nuk është i madh se është i vjetër apo sepse ka sipërfaqe të madhe tokësore, por një popull është i madh kur ka njerëz të mëdhenj siç ishin: Kostantini i Madh, Imzot Niket Dardani, Gjergj Kastrioti, Imzot Pjeter Bogdani, Ismail Qemali, Dom Nikoll Kaçorri, Luigj Gurakuqi, Atë Gjergj Fishta, e shume të tjerë. Siç ishte bija e kësaj toke të dashur, e Lumja Nënë Tereza apo martirët që dhanë jetën për Krishtin gjatë komunizmit duke thirrur para plumbave “Rrënoftë Krishti Mbret,



Rrënoftë Shqipnia”. Një popull është i madh kur merr në dorë fatet e veta siç bëri rinia në vitet 1990-1992 duke detyruar qeveritarët t'a orientojnë vendin drejt Evropës nën thirrjen “e duam Shqipërinë si gjithë Evropa”. Po, populli jonë, pra secili prej nesh, duhet të angazhohet më shumë për të vërtetën dhe të punojë për bashkimin e idealeve të shenjta, Fe e Atdhe.

Të dashur, është Krishtlindje, do të thotë, Zoti me ne. Dhe kur Zoti është me ne, a mund të jemi të shkurrojuar? A mund të mos ia dalim në krye? Jo, me Zotin do të jemi fitimtarë gjithmonë. Me këtë bindje, se me Zotin jemi fitimtarë, ju uroj të gjithëve gëzuar Krishtlindjen dhe bekimi i Foshnjës Jezus, ngjalltë në secilin njeri të kësaj toke shpresë dhe dëshirën për t'u angazhuar në të mirën.

**Imzot Angelo Massafra OFM  
Arqipeshkëv Shkoder-Pult**



## KRISHTILINDJA NË HISTORIN E NJERËZIMIT

## Emërtimet

Është dëgjuar të thuhet për Krishtin herë Jezusi, herë Jezus Krishti, herë Biri i Perëndisë, por edhe emërtime të tjera si Biri i Njeriut, Emanuel, Qengji i Perëndisë. Të gjitha këto emërtime janë tituj hyjnor të hirësisë së këtij personi. Trajta Krisht është greke, dhe shqip d.m.th. I Vajosuri i Hyjit. Grekët e përkthyen emrin e Krishtit nga forma hebreje Mesia (prej këtu janë edhe shprehjet: mesianike, mesiste, mesianik etj.) dhe gjithë kultura perëndimore huazoi nga substrati grek: Christ, Criste, Hrist, Krist, Cristo, Krishti etj. Emri Jezus përdoret zakonisht në Besëlidhjen e Re, derisa Mesia përdorej më shumë në Besëlidhjen e Vjetër (e shkruar në hebraisht). Jezus vjen nga fjala hebraike Jeshua d.m.th. Shpëtimtar, kurse shumë gjuhë evropiane kanë një trajtësim të përafërt: Jehoshua (hebraisht), Iosus (greqisht), Jesus (anglisht, holandisht), Jezus (gjermanisht, shqip), Isus (sllavisht) Gezu (italisht) etj. Pra Jezus Krishti do të thotë Shpëtimtari i Vajosur. Jezusi ka edhe dy tituj mesianik: Biri i Perëndisë (përfaqëson Perëndinë tek njerëzit) dhe Biri i Njeriut – përfaqëson njerëzit tek Perëndia (madje në Besëlidhjen e Re më shumë e hasim si Biri i Njeriut sesa si Biri i Perëndisë). Emërtimet e tjera të mundshme na tregojnë atributet e tij, si: Emanuel, Qengji, Mbret mbi mbretër, Zot mbi zotër, Alfa e Omega, Buka e gjallë, Uji i gjallë, Bariu i Mirë, Besniku, I Vërteti, Ameni, Urtësia, Princi i Paqes, Pajtuësi, Shpaguesi etj.

Sa për kureshtje është shumë interesant se si është formësuar togfjalëshi i dikurshëm lindja e Krishtit në Krishtlindje, dhe nuk ka ndodhur me ndonjë rast tjetër leksikor në gjuhën shqipe e as nuk haset së paku në asnjë gjuhë evropiane as si formulim.

## Paraekzistenca e Krishtit

Sipas doktrinës biblike (judaizmit dhe krishterimit) Jezus Krishti ekzistonte edhe para se të lindte para dy mijë vitesh. Paraekzistenca e Krishtit shpjegohet si një imanencë hyjnore, si një person, pa fillim dhe pa fund, pra e amshueme, si personi apo veta e dytë e Trinisë së Shenjtë të Perëndisë. Bibla, Shkrimi i shenjtë evidenton më shumë se 300 profeci (në Dhiatën e Vjetër), lidhur me ardhjen e Krishtit në tokë. Gjon Ungjilltari në



shkrimin e tij, vargu i parë, për Jezusin apostrofon: *Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte me Perëndinë dhe Fjala ishte Perëndi. Dhe më vonë: Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne e soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë.* (Gjn.1:1,14)

## A u lind Jezusi më 24 dhjetor?

Bibla, nuk ka asnjë të dhënë se Jezusi ka lindur saktësisht më datën 24 dhjetor. Në fakt tregohet se Jezusi lindi në kohën e Cezar Augustit, në vitin e shpalljes së dekretit të regjistrimit të popullsisë dhe në vitin e pestë të sundimit të Herodit. Pastaj Bibla shpjegon se koha kur ndodhi kjo lindje jashtë kishte barinj që i ruanin delet në vathët e tyre. Pra, kështu nuk mund të krijohet bindja se kjo lindje ndodhi në dhjetor, por studiuesit thonë diku në fillim të marsit, apo fundi i shtatorit.

## Jezusi në mes të historisë

Sot gjithë koha historike njësohet me anë të një akti të veçantë: lindja e Krishtit. Prandaj kështu i kuptojmë cilësimet e kohës kur thuhet para Krishtit (para lindjes së Krishtit) dhe pas Krishtit (pas lindjes së Krishtit, ose Anno Domino A.D.), kurse gjatë kohës së komunizmit jo vetëm tek ne por kudo tek vendet komuniste ky njësim ishte zëvendësuar me shprehjet e reja: para erës së re, dhe pas erës së re. Pra Jezusi qëndron në mes të historisë, në mes të epokave, në mes të erave etj.

## Pse u dashtë një lindje e virgjër?

Krishterimi dhe islamizmi pajtohen se Jezusi, përkatësisht Isa, është lindur nga Maria (Mejremja)



në mënyrë të virgjëre. Jezusi pra nuk kishte një baba tokësor, nga mishi dhe gjaku. Engjëlli Gabriel do t'i jepte Virgjëreshës Mari një porosi tejet unike në gjithë historinë njerëzore, dhe të papërsëritshme ndonjëherë, se ajo do ta lindte Birin e Më të Lartit, Birin e Perëndisë. Këtë mision qiellor kjo vajzë e pranoi me gjithë dëshirë dhe përulësi, andaj nga Elizabeta qe shpallur e lume ndër të gjitha gratë. Maria, para 2000 vjetëve u ngjiz përmes Shpirtit të Shenjtë (Frymës së Shenjtë) të Hyjit dhe pastaj u lind Krishti. Pas lindjes së Jezusit, Maria u mor nën kujdesin e Jozefit.

Djali kishte paraprakisht nën pushtetin e tij çdo person përmes mëkatit. Mëkati sipas Biblës është trashëgues, ashtu sikur gjenet. Prejardhja e Jezusit është nga gjiri i Perëndisë, nga qielli, nga drita, atje ku nuk ka fare dyshim e as ndytësi, andaj edhe lindja e Jezusit u bë përmes një rruge të pastër, përmes virgjërisë, dhe në këtë mënyrë djalli kurrë nuk mundi ta ketë pushtetin e tij mëkatnor ndaj Krishtit edhe pse jetonte si njeri. Lindja virgjër e Jezusit është mister i Perëndisë po ashtu, e ne s'mund ta kuptojmë plotësisht, edhe pse duket se është absurde. Sepse është absurde, mister, dhe e pakuptueshme – thoshte Augustini – andaj më duhet të besoj!

### **Kush është Krishti?**

Sot në botë më shumë se një miliard e 200 milionë njerëz pranojnë formalisht se e njohin Krishtin. Në Shkrimin e shenjtë, Bibla, thuhet se Perëndinë askush kurrë nuk e ka parë, por ai i vetmi që zbriti nga qielli e bëri të njohur atë. Jezusi gjatë predikimeve të tij turmave u thoshte se *Unë dhe Ati jemi Një, dhe kushdo që më ka parë mua, ka parë edhe Atin Perëndi*. Krishti mori rrugën e

shpengimit të njeriut nga paudhësia, nga ligësia dhe mëkati, dhe gjithë zemërimi i Perëndisë ndaj njerëzimit u zbras në Krishtin Jezus. Mëkatshmëria e njeriut dhe dashuria e Perëndisë ndaj tij ishin ato që e dërguan Krishtin që të jetë një sakrifice, kurban, në kryq. Ai vdiq, dhe pas tri ditëve u ringjall dhe u ngrit në të djathtën e Perëndisë, dhe sërish do të vijë si Mbret për të sunduar drejtpërdrejt në tokë, dhe kjo përbën gjithë zemrën e ungjillit, apo Lajmit të Mirë. Krishti ka gjithë autoritetin, gjithë hirin dhe pushtetin për t'i falur njerëzit dhe për t'i gjykuar ata. Krishti deri sa jetoi në tokë, 33 vjet, në Jude, ai kishte dy natyra. Natyra e parë ishte hyjnore (ai nuk mëkatoi asnjëherë – vetëm Zoti nuk mëkaton; ai ringjalli njerëz nga të vdekurit – vetëm Zoti mund të ringjall; ai kishte pushtet mbi dukuritë natyrore; ai u fali mëkatet njerëzve – vetëm Zoti mund t'i falë mëkatet; ishte Biri i Perëndisë jo sipas lindje spor sipas origjinës dhe të substancës apo qenies së njëjtë). Natyra e dytë e tij ishte njerëzore (hante, qeshte, flinte, ecte, ishte biri i Marisë). Andaj duke mos u kuptuar drejt natyra e plotë e Jezusit atëherë as nuk e njohim atë plotësisht. Asnjë profet apo i dërguar i Perëndisë nuk mund të krahasohet me Jezusin së paku në shenjtëri dhe mesazh. Përmes Mojsiut erdhi Ligji i Zotit për hebrejtë, kurse përmes Krishtit u derdh hiri i Perëndisë për gjithë botën. Jezusi është avokati ynë tek Perëndia, dhe Zoti e Shpëtimtari ynë personal. Krishti erdhi për t'i shkatërruar planet dhe veprat e Satanës. Ata që e besojnë Jezusin atyre u jep natyrën e tij të re: të lirë nga mëkati, të gëzuar për drejtësinë dhe mrekullitë e Perëndisë Atë.

### **Krishtlindje, Krishtlindjet apo Kërshëndellat!**

Shpeshherë dëgjojmë që të tri këto variante:

Krishtlindja-Krishtlindjet-Kërshëndellat. Trajta Krishtlindjet, është formë e gabuar pasi që shpreh shumësinë e emrit *lindja*. Krishti ka lindur vetëm një herë, mirëpo pavarësisht se tek shqiptarët Krishtlindja festohet në dy data të ndryshme (për katolikë dhe protestantë, dhe ortodoksë) sërish nuk ka baza teologjike as kulturore që të quhet Krishtlindjet. Kurse emri Kërshëndellat në fakt nuk ka të bëjë asgjë me festën e krishterë, pasi që Kërshëndella është një festë e vjetër pagane ilire-shqiptare (Buzmi), dhe lidhet me ngjalljen e tokës për ciklin e ri për jetë, pasi prej 24 dhjetorit toka fillon sërish që t'i afrohet diellit. Festa e Buzmit, tek shqiptarët ju është bashkangjitur festes së Krishtlindjes, por trajta e vetme e drejtë është Krishtlindje ose Krishtlindja.


### Kur filloi të festohej Krishtlindja?

Është për t'u habitur se në historinë e krishterimit deri në shek. IV nuk ka ndonjë të dhënë historike se ishte festuar Krishtlindja ndonjëherë, e aq më pak më 24 dhjetor. Në fakt edhe pse disa libra të Biblës ishin shkruar deri në 65 vjet pas vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit nuk ka ndonjë evidence se të krishterët e hershëm e festonin lindjen e Krishtit në çfarëdo kohe. Por si atëherë filloi festimi i Krishtlindes? Krishterimi deri në shek. IV pas Krishtit ishte nën persekutim nga romakët dhe krishterimi i hershëm nuk manifestoihej përmes shfaqjeve spektakulare. Ata festonin në një mënyrë madhështore Pashkën. Mirëpo atëherë kur Perandoria Romake pranoi krishterimin si religjionin perondorak, atëherë ndodhi edhe

shtetërorizimi, kulturalizimi dhe ideologjizimi i krishterimit. Ai lloj krishterimi që u zhvillua për katër shekuj si porosi e Krishtit përfundoi me legalizimin nga romakët. Romakët fillimisht nuk vërenin tek krishterimi shfaqje universale qoftë ne rite, qoftë ne shfaqje dhe tempament të besimit, atëherë ata bënë atë ridoktrinalizimin e krishterimit që sot quhet katolicizëm (greq. catholicos – i përgjithshëm). Më datën 24 dhjetor romakët kishin festën e tyre kryesore pagane të zotit Dionis, andaj kjo datë u adoptua në mënyrë që të festohej tani Krishtlindja. Pas disa shekujve një prift pati idenë që gjatë kësaj feste të shpërndante dhurata fëmijëve dhe njerëzve të varfër, dhe kjo u shndërrua më vonë në një traditë të fuqishme sa që sot në botën perëndimore dhuratat kryesore mes familjarëve dhe të tjerëve ndahen në vigjilje të Krishtlindjes, kurse komunizmi e zëvendësoi këtë imazh duke shpikur Babadimrin për vitin e ri.

### Festimi i Krishtlindjes sot

Të gjithë të krishterët në botë (katolikët 43%, protestantët 38%, ortodoksët 19%) e festojnë Krishtlindjen me anë të manifestimeve të ndryshme. Katolikët dhe protestantët Krishtlindjen e festojnë më datën 24 dhjetor (sipas kalendarit Gregorian), kurse ortodoksët më 7 janar (sipas kalendarit julian). Në shumë vende krishtere kjo festë e madhe krishterë fillon të manifestohet diku një muaj më herët e diku edhe tre muaj, dhe zakonisht rrugët, sheshet, objektet e ndryshme stolisen dhe ndriçohen tej mase. Shume bredhë zbukurohen, dhe nganjëherë lartësitë e tyre shkojnë edhe deri në 78 m. P.sh. vetëm në Amerikë, gjatë muajit të dhjetorit, shpenzohet aq shumë rrymë elektrike sa nuk bëhet gjatë katër muajve paraprak. Nata e Krishtlindjes në shumicën e vendeve perëndimore festohet nëpër familje, dhe kjo është e vetmja festë që i bashkon familjarët pavarësisht se ku gjenden ata. Familjet blejnë dhurata të shumta dhe i japin njëri-tjetrit. Të burgosurve po ashtu u ndahen shumë dhurata nga të krishterët. Gjatë dy-tri ditëve të ardhshme organizohen shërbesa të ndryshme fetare si dhe programe të tjera festive.



## **SHQIPËRIA FITOI LIRINË PAS SHEKUJSH ROBËRIMI NËN OTOMANËT**

*Provomi i Letrës Baritore, FE e ATDHE, me 11 nëntor 2012 në Shkodër; botuar nga Konferenca ipeshkvor e Shqipërisë, me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, Tiranë, 2012.*

***Dua t'a falënderoj Zotin për të gjithë ata që në nëntorin e 1912 e shpallën Shqipërinë tonë vend më vete dhe i pavarur.***

*Të nderuara zonja zotërinj  
Inderuar mons. Lucjan  
Të nderuar relator dhe autoritete*

Në emër të të gjithë ipeshkvinjëve të Konferencës Ipërshkvnore të Shqipërisë falënderoj relatorët për paraqitjen dhe përshëndetjen e Letrës Baritore si dhe të gjithë ju të pranishëm për interesin që keni shfaqur.

Më lejoni që të bashkëndajë me ju një konsideratë.

Për ne të krishterët libri më i shenjtë është Bibla. Bibla ndahet në dy pjesë, në Besëlidhjen e Vjetër dhe në Besëlidhjen e Re. E gjithë ajo që trajton Bibla është historia e një populli; e popullit të Izraelit. Që nga krijimi Zoti e tërheq dhe formon një popull të zgjedhur për të duke bërë ditë për ditë historin e atij populli dhe kulmon në çastin që nëpërmjet Birit të Zotit, Jezusit, bënë këtë popull dhe çdo popull tjetër, me një dinjitet të ri ... popull i amshuar ... popull që i përket Mbretërisë Qiellore. Zoti është i dashuruar fort me çdo popull dhe me çdo njeri.

Në këtë pikëpamje është e mrekullueshme dhe moment i fortë reflektimi për të gjithë ne shqipëtarët ky përvjetor, pasi ne nuk jemi duke kremtuar vetëm një ditëlindje të Pavarësisë sonë, por ne duhet të shkojmë më thellë e të meditojmë mbi të kaluarën që gëzimi ynë për lirinë e gjetur të mos shteroj më të ardhmen. Në historinë e së kaluarës të ushqehemi me mallëgjim nga bekimi që Zoti ka derdhur mbi vendin tonë e popullin tonë.

Më 1912, Shqipëria vetë fitoi lirinë pas shekujsh robërim nën otomanët. Edhe pse u dhunua e u sprovua nga pushtuesi otoman por kurr nuk u shua populli dhe shpirti i këtij populli evropian. Por kalvari nuk do të mbaronte aty sepse trojet e Shqipërisë u copëtuan dhe shumë toka e bijë na

mbeten jashtë kufinjve si gjak i shprishur. Do të vazhdonte vuajtja edhe në vitet e burgut komunist ku edhe qiellin komunistët do të mundoheshin ta mblonin me tela me gjemba por prap shpirti i popullit tonë ishte shpirt lirie dhe vetë do të kërkonte e fitonte lirinë e fesë dhe liritë e tjera. Sërisht, rruga e nisur shkëlqente por edhe ajo pati dhe vazhdon të ketë vështirësi pasi pushtimet, diktaturat dhe rregjimet që u përplasën mbi popullin tonë kanë lënë gjurmë të thella. Prandaj ky përvjetor duhet të na nxisë që në virtyt të së mirës së përbashkët të marrim në dorë fatet dhe të kërkojmë që me seriozitet të realizohen aspiratat tona për më shumë demokracizim të institucioneve dhe me shumë seriozitet të punojmë për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Dua t'a falënderoj Zotin për të gjithë ata që në nëntorin e 1912 e shpallën Shqipërinë tonë vend më vete dhe i pavarur.

Dua ta falënderoj Zotin për çdo shqipëtar që ndiehet shqipëtarë dhe që e don Shqipërinë dhe mundohet ta ndërtojë atë me sa fuqi ka larg

tundimit për të tërhequr nga vetja. I lutem Zotit të bekojë përpjekjet e tilla.

I lutem Zotit të bekojë Kosovën, dhe nën dritën e të madhit Ibrahim Rugova e burrave dhe grave të tjera që dhanë shumë ajo tokë të përparojë në zhvillim dhe paqe pas genocidit të sprovi.

I lutem Zotit të bekojë edhe çdo trev tjetër ku shqipëtarët jetojnë e ndërtojnë të ardhmen e tyre që me të mirën në zemër të plotësojmë të gjithë amanetin e të parëve që të jemi ndera dhe krenaria e kësaj tokë nënë.

Nën shembullin e bijës sonë, të Lumes Nënë Tereza, shqipëtarët jam i bindur se do të dinë të jenë për Evropën e botën mbarë sa të ketë jetë bota shenjë bashkimi dhe shërbimi, shenjë e bashkëjetesës fetare dhe e respektit për të gjithë.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët.

**+ Angelo Massafra, arqipeshkëv**





## Ligji është diçka e gjallë dhe një fakt i jetës së përditshme

Të nderuar miq,

Ju falënderoj përzemërsisht për ftesën për t'iu drejtuar pjesëmarrësve të nderuar të këtij paneli të zgjedhur.

Është privilegj dhe kënaqësi për mua të përshëndes këtë aktivitet prestigjioz të organizuar nga Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë në vigjilje të përvjetorit të 100 të shpalljes së pavarësisë së vendit.

Në këtë prag 100 vjetori, çdo iniciativë, pavarësisht nga vjen, merr një rëndësi të veçantë. Në momentin e rëndësishëm në të cilin gjendemi, të gjithë kemi një rol për të luajtur dhe përgjegjësi për të mbajtur.

Letra baritore e Konferencës Ipeshkvnore është shkruar për të gjithë. Është shkruar me gjuhën e thjeshtë të njerëzve të thjeshtë dhe me urtësinë që karakterizon autorët e saj.

Dhe kështu duhet të kuptohet prej të gjithëve, drejtpërdrejtë.

Po i referohem një fjalie të përfshirë në kapitullim "Edukimi me ligjin dhe respektimi i tij" të kësaj letre: *"T'i shërbesh e ta duash atdheun lidhet edhe me edukimin me ligjin dhe respektimin e tij."*

Gjithsecili prej nesh, pavarësisht pozicionit të tij në shoqëri, ka detyrim njerëzor e atdhetar të luajë rrolin e tij aktiv në respektimin e ligjit. Dhe gjithsecili duhet ta kërkojë këtë fillimisht nga vetvetja.

Ligji është diçka e gjallë dhe një fakt i jetës së përditshme. Ai është një produkt, i cili ka miliona konsumatorë. Çdokush duhet të marrë parasysh ligjin, funksionimin e tij dhe të sillet e të veprojë në përputhje me të.

Por për fat të keq, ligji dhe komuniteti i ushtrimit të ligjit në disa raste janë larg nga njëri tjetri.

Siç mund ta dini, gjyqësori kuotohet ulët në shumë sondazheve të zhvilluara për këtë qëllim. Perceptimi i publikut për sistemin e drejtësisë dhe për atë gjyqësor në veçanti janë shumë domethënës për ne të gjithë. Zbatimi i dobët e i shtrembëruar i ligjit, transparencja e ulët të proceseve penale dhe civile të drejtësisë janë disa nga problemet më shqetësuese në sistemin e drejtësisë që kanë sjellë shkallë të ulët besueshmërie të publikut në sistemin gjyqësor;

Ndreqja e kësaj situatë është eminente për ne!

Këshilli i Lartë i Drejtësisë beson se transparencja është mjete më i mirë për të luftuar korrupsionin. Ne e kemi të qartë dhe të përcaktuar strategjinë se si mund të fitohet kjo luftë dhe vullneti nuk na mungon.

Në rast se ne jemi të pazotë të ushtrime ligjin, ne kemi dështuar qysh në fillim dhe prishim brenda sekondës një sistem të tërë. Këtu nuk kemi sundim të ligjit por vetëm ligj pa sundimtar. Dhe kjo nuk është një situatë demokratike.

Askush nuk mund të jenë vetëm vëzhgues, të gjithë duhet të veprojmë me mundësitë që kemi, duke e respektuar ligjin dhe duke edukuar dhe kërkuar nga të tjerët respektimin e tij. Kjo është detyra e shenjtë jo vetëm e gjykatave, Parlamentit, e Ministrisë së Drejtësisë, e partive politike, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por mbi gjithçka e komunitetit të zbatuesve të ligjit, në të gjitha format e tij. Kjo është detyra e çdo shtetasi të mirë, sepse pa ligje që zbatohen nga të gjithë nuk mund të ketë shtet!

Në përfundim, unë besoj se një mesazh që të gjithë ne këtu duam të përcjellim sot është ky : ligji duhet ushtruar plotësisht, pushteti i ligjit duhet të mbizotërojë, qeveria, zyrtarët e saj ashtu sikurse njerëzit e thjeshtë duhet të jenë të parët që e garantojnë këtë. Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe ai është i njëjtë për të gjithë!

Ndaj edhe ju falënderoj nga zemra për këto mesazhe kaq serioze dhe të nevojshme që jepni për të gjithë ne, me anë të kësaj letre baritore.

**Elvis Çefa- Tiranë**

## Drejt Evropës, qytetarë të një vendi në Evropë

*I nderuar Imzot Angelo Massafra, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë,  
Zonja dhe zotërinj,*

Letrës baritore të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së atdheut nuk mund t'i mungonte pohimi i thelbit euro pianist të identitetit kombëtar të shqiptarëve dhe lidhur me të thirrja për të vazhduar si komb, pa u lodhur dhe pa u dekurajuar nga asnjë lloj pengese, udhëtimin jetik dhe historik drejt Evropës.

Ky është udhëtimi i kthimit në shtëpi, në rrugën që kishim humbur, por që e kemi gjetur më në fund, pas një mijë e një fatkeqësish, aksidentesh e peripecish kombëtare në stuhitë e fatit, që

vazhduan përgjatë 500 vjetëve të pushtimit otoman dhe 50 vjetëve të regjimit komunist izolacioniste.

Ky është udhëtimi i bashkimit tonë me familjen tonë të natyrshme evropiane. Është me të vërtetë një mrekulli dhe jemi vërtetë me fat që na shorti ta jetojmë dhe ta shërbejmë me mish e me shpirt këtë aspiratë të vjetër dhe të re të shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje. Shqiptarët janë të bashkuar në ëndrrën evropiane ashtu siç janë të lidhur në gjuhën e tyre të lashtë dhe në atdheun e tyre të përbashkët si përmasë shpirtërore. Gjuha, Atdheu, Evropa- ky është trinomi që i sheh sot shqiptarët në varkën e fatit të tyre të mbarë e të sigurte.

Kjo histori është e vjetër, shkon thellë në kohë. Por unë dëshiroj të evokoj kapitullin me të ri të kësaj historie. Njëzet e dy vjet më parë këtu në Shkodër u tha mesha e parë pas ndalimit përgjatë 23 vjetëve të feve nga regjimi komunist. Zëri i besimit në Zot, domethënë Zëri i Zotit lajmëroj ngadhënjimin mbi shtypjen dhe një ardhmëri të re për këtë vend të djegur nga pushtimet, sundimet dhe ideologjitë njerëzore. Një muaj më vonë studentët e Universitetit të Tiranës dhe intelektualët që u bashkuan me ta ç shpërthyen lëvizjen e mirënjohur për Liri dhe Demokraci. Po të hyjmë e të kërkojmë do të gjejmë shumë fije që lidhin meshën e parë në Shkodër me Lëvizjen Demokratike të Dhjetorit në Tiranë. Mesha si demonstrimi i parë i lirisë së besimit mbi gërmadhat e ateizmit dhe shtypjes shumëvjeçare e paralajmëroi lëvizjen e studentëve, e thirri në skenën e historisë, e bekoj me bekimin e zotit. Por filli më i qenësishëm për bashkues i këtyre dy ngjarjeve të mëdha është Evropa. Mesha ishte, ndër të tjera, vokacioni i rilindur i një kujtimi dhe ëndrre të vjetër e të pashuar shqiptare. I njëjti kujtim dhe e njëjta ëndërr ishin gjithashtu vokacioni i Lëvizjes Studentore, që u shpreh më mirë se në asgjë tjetër në thirrjen e tyre të njohur “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa”. Kam lexuar shumë për lëvizjet demokratike të fundit të viteve nëntëdhjetë në vendet ish komuniste të Evropës. Kam gjetur kudo diçka të veçantë të kolorit apo historisë vendore. Shqipëria është i vetmi vend ku Lëvizja Demokratike u zhvillua nën thirrjen për Shqipërinë evropiane. Në fakt nuk ishte thjesht një slogan, një parullë, por shumë më tepër se kaq. Ishte manifesti i rrugës së re të Shqipërisë, i së ardhmes së afërt e të përjetshme të saj, i mbledhur në tri fjalë sakrale, si ato që mbesin nga puna e

shekujve apo si ato që gdhenden prej një çasti të rrallë historik. Rasti e ka sjellë të jem një dëshmitar i afërt e disa prej ngjarjeve kulmore të tranzicionit demokratik, kam qenë i pranishëm në formulimin e shumë sloganeve dhe programeve politike që publiku i ka njohur përgjatë këtyre viteve. Por nuk dëshmoj dot dhe nuk kam gjetur kurrkënd të dëshmojë se kush e formuloi i pari manifestin me tri fjalë “Shqipërinë si gjithë Evropa”, manifestin që drejtoj përgjithnjë shigjetën



e kohës së Shqipërisë drejt Perëndimit dhe vlerave perëndimore. Nganjëherë- dhe me lejohet ta them këtë në një evidentë të konferencës ipeshkvnore- me shkon mendja se Zoti vetë e tha me gojë, Zoti ua diktoj dikujt apo disave në qytetin Studenti. Por ndoshta kjo e autorësisë nuk është shumë e rëndësishme përderisa vetë historia ka dashur t'ia lërë në zotërim anonimatit. Madhështor është fakti se demokracia e re shqiptare është pagëzuar përgjithmonë në fjalën e Evropës dhe evropianizimit.

Koha gjatë këtyre dy dekadave ka treguar se vokacioni evropian i studentëve të Dhjetorit 1990 ishte dhe është vokacioni i shumicës dërmuese të shqiptarëve. Nuk është as e tepërt, as e mërzitshme të përsërisim se jemi populli më pro evropian i

Ballkanit. Mbi nëntëdhjetë e pesë për qind e shqiptarëve mbështesin projektin e hyrjes së Shqipërisë në Evropës. Shifra nuk ka lëvizur, pavarësisht turbulencave politike që kanë prekur kalendarin e integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

Kjo do të thotë se shqiptarët e sotëm nuk e kanë parë e nuk e shohin Evropën si një interes imediat apo thjesht si një mundësi për përfitime materiale, sado që edhe këto kanë rëndësinë e tyre. Shqiptarët, ndryshe nga disa popuj të tjera të rajonit, e shohin hyrjen në Evropë parasë gjithash si histori, më saktë si fundin e një historie të vështirë dhe të errët dhe fillimin e një historie të re të sigurisë dhe prosperitetit demokratik.

Prandaj kanë durim dhe nuk tunden nga oscilacionet politike të agjendës së integritit. Me tri besimet dhe me katër komunitet të tij fetare, por edhe me mbarë spektrin e partive politike populli shqiptar përfaqëson një identitet unik që aspiron evropianizimin.

Në kontekstin e historisë nga vijmë, kjo është vërtetë një gjë e jashtëzakonshme. Kur mendojmë kalimin nga mesjeta në pavarësi, nga pavarësia në komunizmin më të egër dhe nga komunizmi më i egër në demokraci, nuk mund të mos ndjehemi krenar e të lumtur me përparimin e madh që ka shënuar evropianizimi në Shqipërinë e këtyre njëzet vjetëve.

Por dihet se demokracia krahasohet e duhet të krahasohet me vetveten, me standardet e saj dhe jo me të kaluarën. Standardet janë peshorja e drejtë e arritjeve demokratike, standardet janë forca e brendshme lëvizëse, përherë ripërtëritëse e demokracisë.

Nga ky këndvështrim, shihet qartë se jemi vonuar pak në rrugën e integritit evropian. Arsyet janë komplekse dhe nuk është rasti për t'i analizuar në këtë takim sollëm. Megjithatë pyetja "pse vonohemi" është legjitimime këtë rast ia vlen të nënvizojmë dy gjera: e para, se integrimi nuk ka qenë e nuk mund të jetë një çështje një partizane apo vetëm mbi partizanë, por kombëtare. E dyta, çdo lloj interesi i pjesshëm, çdo mëdyshje apo tundim që shkon në kundërshtim me aspiratën e fuqishme për integrim evropian është antipopullor dhe pa të ardhme.

Po i drejtohem fundit duke evokuar një fragment nga drama e shkurtër e at Gjergj Fishtës "Nën hajat të Parrisit". Skënderbeu takon djalin që sapo ka mbërritur me lajme nga toka dhe e pyet:

-Si janë Shqiptarët e Shqipërisë.

-Si janë? Si i donë armiku?- i përgjigjet djalli.

At Gjergj Fishta ka dashur të ne nënvizojë me këtë fragment rolin e përçarjeve të brendshme në minimin e aspiratave qytetëruese evropiane të shqiptarëve. Kohët kanë ndryshuar, shqetësimi i patriotit dhe klerikut të madh nuk mund të jetë sot ai që ka qenë kur shkroi dramën e tij, por shenjat e një lloj vështirësie për t'u marrë vesh, si shprehje e një ngërçi të vjetër, siç ka nënvizuar shkrimtari i shquar Ismail Kadare në esenë e tij "Mosmarrëveshja", janë akoma prezentë dhe kërcënojnë gjithnjë ëndrrën evropiane të shqiptarëve.

Investimi në rrugën e bashkimit dhe unitetit nëpërmjet zgjimit të kujtesës, ndjenjave dhe përgjegjësi euro pianiste të publikut si dhe plotësimi një për një nga institucionet i kritereve të integritit që Bashkimi Evropian ka caktuar për Shqipërinë janë kura kundër çdo vonese, dileme apo pengese.

Në këtë kuadër kam nderin të vlerësoj lart thirrjen shumë domethënëse "Drejt Evropës" të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë në letrën baritore drejtuar besimtarëve katolikë dhe mbarë popullit shqiptar.

Kjo është thirrje e re që kumbon fuqishëm në rendin e detyrave që duhet të përmbushim për të zënë e për të mbajtur me nder vendin tonë në familjen e madhe evropiane.

Ku më mirë do ta dëgjojmë e ndjejmë se në ato navata, nën ato kube apo absida që mbrojtën nëpër shekuj, bashkë me kalatë e tjera të shqiptarisë, gjuhën dhe rrënjët e kombit, sekretin tonë të mijëvjeçareve?

Kujt tjetër në mirë do t'u kishte hije kjo thirrje se sa trashëgimtarëve në besim dhe detyrë të martirëve të Shqipërisë evropiane, që predikojnë Atdhe e Fe me gjuhën e Skënderbeut, Pal Engjëllit, Pjetër Bogdanit, Gjergj Fishtës, Nikollë Kaçorrit, Anton Harapit e qindra të tjerëve, me të njëjtat petka të shenjta të klerikëve heroikë, në të njëjtat katedra dhe altarë ku fjala e zotit behët fati i popullit!

Lajmet më të mira nga fronti i integritit evropian i kemi përpara. Me udhëheqësit e vet shpirtërore në ballë, por edhe me ata politikë, qytetarët shqiptarë do të vazhdojnë në rrugën e Evropës me vetëdijen se po kthehen në shtëpinë e të parëve dhe të mbrëmjeve dhe- nuk është e tepruar ta themi- me vendosmërinë prej Abrahami që është thirrur të kalojë nëpër prova të forta drejt mbërritjes.

**Preç Zogaj- Tiranë**

## EKSPOZOHEM “MESHARI” I GJON BUZUKUT NË TIRANË

*Kryeministri Berisha dhe kryetarja e Kuvendit, Topalli në ceremoninë e ekspozimit të “Mesharit”*

Si një libër i adhurueshëm, që dokumentoi shqipen e shkruar, që i vuri një ditëlindje, i meritonte të gjitha masat e sigurisë dhe shtyrjet e kureshtarëve për ta parë. Pas 5 shekujsh, libri i parë shqip, “Meshari” i Gjon Buzukut, u ekspozua dje në ambientet e Bibliotekës Kombëtare. Të pranishëm ishin studiues të letërsisë, historianë, por edhe Kryeministri i vendit, Sali Berisha, kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli, kryebashkiaku i Tiranës, Lulzim Basha, ministri i TKRS-së, Aldo Bumçi, ai i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, Nunci apostolik në Tiranë etj.

Jo me pa të drejtë, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Aurel Plasari, e quajti një “ceremoni historike”. “E quaj historike, sepse për gati dy shekuj që shqiptarët e kanë zbuluar, nuk kanë mundur ta kenë. Edhe studiuesit e tij më të mëdhenj, si Zamputi, Riza, Çabej etj. nuk kanë pasur mundësi që ta kenë ndër duar, por kanë shfletuar vetëm riprodhimin e tij”, tha Plasari, duke shprehur mirënjohjen kundrejt ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Aldo Bumçi, “i cili nuk u kënaq vetëm duke e parë dhe prekur vetë, por kërkoi sjelljen e tij në Shqipëri”, gjithashtu edhe qeverinë shqiptare, që kaloi të gjitha vështirësitë administrative, duke mundësuar ardhjen e tij në Shqipëri”.

### Gjuha liturgjike

Kryeministri Sali Berisha e quajti një ngjarje unike ekspozimin e “Mesharit” të Gjon Buzukut në Tiranë. Sipas tij, me këtë libër Buzuku, por edhe shkruarit e pastruesit e parë të gjuhës shqipe, si Bogdani, Budi, Matrënga e Variboba, dëshmuar se edhe kombi shqiptar, ashtu si edhe kombet e tjera, nën frymëzimin e Rilindjes italiane, filluan një lëvizje të fuqishme kombëtare. “Tek ne, identiteti kombëtar ka për shtyllë kryesore gjuhën e kombit. Sa më shumë ta studiojmë këtë gjuhë dhe të hulumtojmë për ecurinë, aq më shumë do të kontribuojmë në njohjen me të mirë të identitetit tonë kombëtar shqiptar”, tha Berisha. Ndër të tjera, ai tha se patriarkët e shqipes, si Buzuku, Budi e Bogdani, themeluan gjuhën zyrtare, atë liturgjike, e cila për dekada me radhë gjatë periudhës së



diktaturës u syrgjynos. “Të gjitha ndërhyrjet që u bënë në gjuhën shqipe kanë pasur vetëm një qëllim satanik: shmangien me çdo kusht të gjuhës së bukur liturgjike. Nuk mund të pranohet që një situatë e krijuar mbi bazën e një dogmë totalitare, të zëvendësojë doktrinat e vlerave njerëzore e hyjnore. Unë kam besim se studiuesit, gjuhëtarët tanë do të gjejnë mençurinë e kurajën për ta rikthyer në gjuhën shqipe, gjuhën e bukur liturgjike, gjuhën më të hershme të shkruar të kombit. Të mos harrojmë se kombe të mëdha, që kanë pasur filozofë ndër më të mëdhenjtë, shkrimtarë gjenialë, gjuhën zyrtare ia detyrojnë përkthimit të Biblës”, tha Berisha.


**Ekspozita** Bashkë me “Mesharin” e Gjon Buzukut, i cili ishte vendosur qysh në krye të sallës së ekspozimeve në Bibliotekën Kombëtare, u ekspozuan edhe një kolanë me veprat e para të shqipes së shkruar. Një ndër ta ishte “E mbesueme e krishterë” i Lekë Matrëngës, i cili daton në vitin 1592, një vepër e cila gjithashtu ka njohur një histori humbje-gjetjesh. Në Bibliotekën Kombëtare ruhet një ekzemplar i fotografuar i veprës, ndërsa mendohet që një ekzemplar i librit të Matrëngës ruhet në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit. I vitit 1618 është “Doktrina e krishterë” e Pjetër Budit, ku veç parathënieve dhe pasthënieve të Budit, gjenden 19 vjersha fetare të përshtatura nga latinishtja ose italishtja, ndërsa ka edhe krijime origjinale në gjuhën shqipe. I 1592-shit është një riprodhim i “Pasqyrës së të rrëfyemit”, po i Budit,

ku gjenden edhe tri vjersha në gjuhën shqipe, për të vazhduar me “Ritualin roman” (1621). Nga Frang Bardhi është ekspozuar vepra e tij më e rëndësishme, “Fjalori latinisht-shqip” (Latino-Epiroticum) i 1635-s. Një nga veprat më të rëndësishme të gjenezës së shqipes së shkruar dhe të kësaj ekspozite është padyshim “Çeta e profetëve” (“Cuneus profetarum”) i Pjetër Bogdanit. Sipas studiuesve, mendohet që kjo vepër, e cila në përbërje të saj nuk ka vetëm përkthim, por krijime të mirëfillta, i përket vitit 1585. Nga fondi i Bibliotekës ishin nxjerrë edhe ribotime të këtyre librave, si edhe kopja e “Mesharit” të Gjon Buzukut, vendosur përmbri atij original.

**Ekspozimi në kushte të larta sigurie** “Meshari” i Gjon Buzukut, i shkruar në vitin 1555 dhe “sivëllezërve” të tij, siç i quan drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Aurel Plasari, do të jetë i ekspozuar për publikun deri në fund të muajit nëntor. Ashtu siç erdhi deri në Tiranë, libri do të jetë i ekspozuar nën kushte të rrepta sigurie. Ai do të jetë i ruajtur gjatë 24 orëve nga forcat e Policisë së Shtetit, me të cilat është lidhur edhe një

marrëveshje. Ky ishte edhe një nga kushtet e vendosura nga Biblioteka e Vatikanit për sjelljen e tij në Shqipëri. Po kështu, edhe në kushtet e duhura klimatike. Libri ka ardhur i mbyllur në një valixhe të posaçme, ndërsa ekspozitori, që i siguron një temperaturë dhe lagështirë konstante, si dhe ruajtje nga drita, dy ditë më parë. Sipas drejtorit të Librit pranë MTKRS-së, Ermir Nikës, të gjitha kushtet u plotësuan sipas kërkesave të Vatikanit, të cilët dërguan ekspertët e tyre për të monitoruar gjithçka. U vendos ndriçim i ri, kondicionim, madje edhe vitrinat e librave të tjerë që u ekspozuan bashkë me “Mesharin”, sipas Nikës u prodhuan sipas modeleve të Vatikanit, për librat antikuarë. Sa i takon temperaturës së sallës, ku është ekspozuar, ajo nuk do të jetë më shumë se 18 gradë celsius. Ardhja e “Mesharit” u bë e mundur pas kërkesës së ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Aldo Bumçi, gjatë një vizite të tij në Vatikan. Ky ekspozim është pjesë e festimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë.

**Marrë nga gazeta Panorama: Martë, 13 Nëntor, 2012**



**Tomë Mrijaj**  
New York

**“PAQE NË BOTË DHE LIRI PËR POPUJT E ROBNUEME”**  
**Lutja në 49-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë**  
*Në 100-vjetorin e lindjes të Mons. Dr. Zef Oroshit (1912-1989)*

Historia e klerikut të shquar Mons. Dr. Zef Oroshi, është e lidhur me vendlindjen e tij në Kaftall të Oroshit, aty ku zënë fill ngjarjet e mëdha të Derës së Kapedaneve të Mirditës, që për pesë shekuj me radhë luftuan pareshtur kundër mizorive të Perandorisë Otomane, duke ruajtur gjithnjë identitetin kombëtar, gjuhën, fenë, traditat dhe kulturën tipike iliro-arbërore-shqiptare.

Më 23 Nëntor të vitit 1912, pikërisht pesë ditë para Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorën historike, në ato ditë, kur vendit i vinte era e tymit të barutit të nxehtë, lindi fëmija, që u pagëzua me emrin Zef Çoku, në Kaftall të Mirditës.

Mësimet fillestare Zef Oroshi i mbaroi në vendlindje, ndërsa studimet e mesme i nisi në vitin 1927, në Seminarin Saverian të Urdhërit Jezuit në Shkodër. Ai shquhej si fëmijë i zgjuar e i zellshëm mes shumë nxënësve të tjerë të shkollës.

Pader Ejëll Serreqi S.J. tek nxënësi mirditor spikaste zgjuarsinë dhe vokacionin e mundshëm për klerik. Ai e drejtoj Zefin në Seminarin Pontifikal në Shkodër, qytet i njohur për kulturë, fe dhe traditë.

Ish nxënësi i Mjedës dhe Fishtës, studenti Zef Oroshi, më 1936-1940, nisët në Romë, për të vijuar studimet e larta filozofiko-teologjike, pranë Universitetit të Urbaniano, në “Propaganda Fide”, ku, pas përfundimit të studimeve do shugurohej, po në këtë Kolegj për meshtar.

Ai ishte shumë i gëzuar, se po kremtonte meshën e parë, por edhe i prekur, sepse atë vit më 1940 kaloi në amshim “Poeti Kombëtar” At Gjergj Fishta O.F.M. (1871-1940), të cilin ai e kishte takuar disa herë, kur ishte nxënës në Shkodër dhe student në Itali.

Pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste (7 Prill 1939), i riu Zef Oroshi e priti me një shqetësim të madh. Ai, gjatë kësaj kohe në shenj krenaria për kombin e vet, në dhomën e gjumit e mbante flamurin e Skënderbeut. Ndjenja e lartë e lirisë, ishte shumë e zhvilluar në shpirtin e tij. Kjo vinte me sa duket nga edukata e shëndoshë atdhetare, që kishte marrë në familje dhe më vonë në kuvendet katolike në Shkodër, që ishin dhe mbetën vatra, nga ku shpërndaheshin rreze të ngrohta të atdhedashurisë pakufi për trojet, historinë, kulturën



dhe qytetërimin autokton shqiptar.

Mbas studimeve rikthehet në vendlindje. I peshkvi Imzot Frano Gjini e emëron famullitar në Kishën e Shën Marisë Magdalenë në Ungrej të Mirditës, ndërsa, më vonë e cakton në Orosh dhe ndihmës të tij për dioqezën e Mirditës.

Ishte kohë e kobshme, kur komunizmi kishte nxjerrë tentakulat e veta kanceroze dhe po shkatërronte me themel çdo vatër të kulturës dhe qytetërimit perëndimor evropian dhe shqiptar.

Studiuesi dhe albanologu gjerman bashkëkohor, Dom Dr. Markus W. E. Peters, në librin e tij: **“Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996”** (Tiranë, 2010), ndër të tjera shkruan: *“... dihej se D. Zef Oroshi në mars të vitit 1951 donte të organizonte një kryengritje në Mirditën katolike. Në atë periudhë, pati përpjekje sporadike nga Italia, për të infiltruar agjentë, me qëllim përmbysjen e sistemit në*

*Shqipëri. D. Zef Oroshi me Jak Përrjakun, u përpoqën ti organizonin këta njësi së bashku me familjet mirditore. Si rezultat zona katolike e Mirditës u sulmua më shumë se të gjitha zonat e tjera të Shqipërisë. Bilanci ishte: mbi 200 të vrarë ose të dënuar me vdekje, mbi 270 të burgosur dhe mbi 500 të internuar... Siç shihet D. Zef Oroshi ishte një ndër personat më të kërkuar në Shqipërinë e atëhershme.” (f.197).*

Ndërsa, studiuesi tjetër, Dr. Pjetër Pepa, në librin e tij: **“Tragjedia dhe lavdia e Klerit Katolik në Shqipëri”** (Tiranë, 2007, Volumi II), duke nxjerrë në dritë qëndrimin burrëror antikomunist të meshtarit mirditor, vlerëson: *“Mons. Dr. Zef Oroshi, për lidhjet që ka realizuar me Vatikanin, përmes “diversantëve”, lidhur me mënyrën se si u zhvilluan ngjarjet në Shqipëri, për miratimin e Statutit, kërkohet më çdo kusht arrestimi i tij nga komunistët, ndaj ikën dhe bashkohet me luftëtarët antikomunistë, maleve të Shqipërisë. Mbi bazën e dokumenteve arkivore të Ministrisë së Brendshme, rezulton se ikja e tij, në kufirin shqiptar të asaj periudhe, ka qenë e një rëndësie të veçantë. Mehmet Shehu, vetë tregoi interesim të veçantë për te dhe, për të evituar ikjen përtej kufijve e për ta kapur me çdo kusht, përveç forcave të ndjekjes, aktivizoi edhe disa klerikë, që i dërgoi në Mirditën e atyre ditëve, për ta kërkuar e gjetur me çdo mënyrë, nëse ishte ende brenda kufijve të Shqipërisë, këtej maleve të Mirditës.” (f.260)*

Mirditori i shquar, Mons. Dr. Zef Oroshi, u bë kleriku më me peshë në botën shqiptare të Amerikës. Intelktuali erudit, qysh në vitin e parë të jetës së meshtarisë e kthen në traditë festën e 28 Nëntorit 1912, shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, duke e përkujtuar me një meshë speciale të përvitshme, me anën e së cilës, ai lutej me gjithë shpirt së bashku me besimtarët: *për të gjithë dëshmorët e kombit shqiptarë, të rënë gjatë shekujve dhe për interesat e larta të Atdheut.*

Meshtari Dom Rrok Mirdita (sot Shkëlqesia e Tij Arqipeshkvi i Arqipeshkvis Metropolitane Tiranë-Durrës), i cili e zëvendësoi Mons. Oroshi, (mbas kalimit të tij në amshim) e vijoi dhe me tej traditën e përkujtimit të kësaj date kombëtare, duke celebruar meshën special, për shpirtin e të gjithë dëshmorëve të rënë në kohëra të ndryshme, për idealin e shenjtë kombëtar.

Kleriku i përkushtuar, atdhetari i palodhur i Përndritshmi Dom Pjetër Popaj, vijues i binomit Fe e Atdhe, përveç meshës së përsheptshme përkujtimore, për të gjithë dëshmorët e trojeve etnike, e kremte tashmë të kthyer në traditë, ai në

ketë ditë feste, **nën tingujt e Hymnit Kombëtar me krenari ngre Flamurin Shqiptar**, mbi kambanoren e Kishës Katolike “Zoja e Shkodrës”, në Hartsdale New York, në datën e shënuar të 28 Nëntorit.

Kur dëgjohej kumbimi melodiozë i fjalëve të zjarrta, të Mons. Dr. Zef Oroshi (Themeluesit të Kishës së Parë Katolike Shqiptare në SHBA) të mbushura më plot frymëzim atdhetarie, te qindra shqiptarë, emigrantët të Amerikës, pa dallime feje dhe ideje, rritej edhe më shumë atdhedashuria për trojet tona amtare.

Ai, qëndronte në qelën e tij deri në orët e vona të natës, duke punuar me shumë përkushtim dhe kujdes, në hartimin e mesazhit dhe lutjeve shpirtërore për popullin shqiptar dhe në veçanti atë fatkeq, që jetonte pas hekurave, brenda burgut të madh të rrëgjimit komunist në Shqipëri.

Mons. Oroshi, me bashkatdhetarët nga Kosova, Italia dhe të SHBA-as, shprehej me shumë zemërim për persekutimin e pashembullt ateist, që rrëgjimi komunist i bënte popullit shqiptar dhe klerit katolik në veçanti.

Kujtoj, me shumë respekt, disa raste mbresëlënëse të meshtarit tonë dhe ndjenjat të larta dhe të thella patriotike.

Mbaj, mend në kujtesën time ende si të freskët, një detaj shumë domethënëse, kur Mons. Oroshi, nuk lejoi turmën e dasmorëve të hynte në Kishën “Zoja e Kshillit t’Mir” (sot “Zoja e Shkodrës” në Hartsdale, New York) me flamur me yllin e verdhë bolshevik rus, mbi shqiponjën dykrenore. Ketë bastarllim e quante një krim të madh, që komunistët në vendlindje dhe diasporë ia bënin *Simbolit Kombëtar* të heroit tonë, Gjergj Gjon Kastriotit. Ky *Flamur*, pas shumë vitesh, qe ngritur nga fatosi i lirisë Dedë Gjon Luli me malësorët e tij, më 6 Prill 1911 në majën e Deçiqit. Kurse, një vit më vonë flamuri u ngrit nga plaku i urtë mjekërbardhë Ismail Bej Qemali së bashku me shumë patriotë të tjerë, në Vlorë më 28 Nëntor 1912, duke shpallur Pavarësinë e Shqipërisë.

### **Lutja e Dom Zef Oroshit**

Gjatë hulumtimeve të mia dhe kontakteve të përditshme, që kam pasur me miqtë e Mons. Oroshit, kam mundur të siguroi një dokument, që titullohet: **“Lutja e Dom Zef Oroshit”**.

Ajo, që bie në sy, në ketë Lutje, është fryma dhe përmbajta e thellë atdhetare e cila dominon në këtë Mesazh-Lutjeje. Kjo lutje është e njëjtë me shumë lutje të tjera, që ai ka shprehur për çdo vit në përvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

Ketë dokument, për herë të parë, mbas 51

vjetëve, po sjelli para lexuesve shqiptarë. Dokumenti është lexuar në kremtimin e 28 Nëntorit të Pavarësisë së Shqipërisë, New York, 1961, që titullohet: LUTJE për mbarë shqiptarët nëpër botë dhe në veçanti për komunitetin e vogël në SHBA.

“O Zot i gjithpushtetshëm e i amshuem, krijuesi i qiellit dhe i dheut, zotnues i popujve, kombeve e i qeveritarëve të tyne, ke Ti ma së parit po e çojmë mendjen dhe naltësojmë zemrat, në këtë ditë përkujtimore të 49-vjetorit të Pamvarësisë s'onë kombëtare, bashkë me miq e dashamirë të Kombit t'onë, të cilët në një front me ne përpiqen e luftojnë për të njëjtën kauz të shënjtë: **Paqe në botë dhe liri për popujt e robnueme.**

Emni Yt ishte i nderuem dhe i lavduem nga Populli shqiptar i tri besimeve, kur gëzonte atë liri që Ti vetë në sheshtimet e Tua të pamatëshme ke ndikue me ndergjegjen e secilit njeri e, rrjedhmënisht, të së cilit komb e krejt gjinisë njerëzore.

Por sot, n'atë vend të lamë me gjakun e të parëve t'anë për ta rifitue e mbrojtë atë liri, Emni i Yt asht sha e përbuzë, faltoret ndërtue për nderimin t'And janë shkretue, rrëzue ose sjellë në përdorime të pa deja, nga një tok bijsh të verbuem t'atij populli.

Por na po të lutemi, përfaqsesit e tri besimeve këtu tok sikur jemi, të lidhun e të vllazënuem me gjak, ideal e besimin ngulmënisht në Ty, jo për meritat t'ona, por n'emen t'atyne vllazënve t'onë që kanë mbështet uzdajën në Ty ndër vuejtje e salvime, për mundimet e sa e sa të pafajve të ngujue rreptësisht në burgjet ose ndër kampet e vdekjes të punimeve të detyrueshme, n'emën të gjakut të flijuem nga vllaznit ma të mirë për t'i ndejë ngulmënisht besimit në Ty, o Zot, e moralit dhe traditës së Kombit të tyne, sjelli sytë e Tu të mëshirshëm mbi Kombin t'onë, Shqipninë. Shikoji me përdëllim vuejtjet e atij populli.

Ndriçoji sot të gabuemit e të verbuemit; ndaji e shpërndaji, shkatërroji e shfarosi fuqitë e mbrapshta që veprojnë me hollësi satanike për zhdukjen e shrranjosjen e Emnit t'And deri nga zemrat e foshnjeve e të popullit t'And shqiptar.

Bekoje, o Zot emigracionin t'onë! Jepi fuqi e organizim për të nderue Emnin t'And e t'Atdheut nder kombe mikpritëse ku gjendet. Shtojau e persosjau idealin e shenjtë që kërkon momenti historik i Kombit, bashkimin e vllaznimin. E sikundër nëpër duert e pafuqishme të Juditës, asgjasove madhështinë e Holofernit e nëpër duert akoma të njoma të bariut David plandose për dhe blasfëmuesin e Emnit t'And, viganin Goljath, ashtu forcoje Emigracionin t'onë për t'i ba ballë me nder,

bashkarisht e vllaznisht me të gjitha kombet e botës së lirë, luftës së gjithanëshme të komunizmit atheist e agresiv, mohues dhe luftues i çdo lirie dhe besimi.

Jepu, o Zot, dritë, paqe e lumni të përjetëshme gjith patriotëve bashkëvllazën që, o ndër malet e thepisuna o ndër burgjet e kampet e vdekjes, flijuen jetën e tyne ne altarin e Atdheut për t'i ndejë besnik Ligjes s'Ate dhe lirisë së Kombit shqiptar e për jetë i pashlyeshëm goftë kujtimi e shembulli i tyne ndër zemrat e mendjet t'ona e të breznive t'ardhëshëm në tokën t'onë shqiptare.

Bekoje, o Zot, e jepi mirëvajtje këtij Kombi ku gjindemi e gjith popullit liridashës së tij, që me një bujari, vetmohim dhe humanitarizëm shembullor, ka ndihmue e ndihmon Emigracionin tonë dhe çashtjen e shejtë tonën për liri.”





**Andrea Marko**  
Shkodër

## JEZUITËT E MUZIKA

Rrallë herë në historinë e Kombit Shqiptar mund të gjesh një qendër fetare, kulturore dhe arsimore që i ka dhënë aq shumë atdheut siç i kanë dhënë etërit – Jezuitë dhe shkollat e tyre “Kolegji Saverian” e “Seminari Papnor” Shqiptar.

Ashtu siç tashti dhe dihet ata u vendosën në token shqiptare 300 vjet pas themelimit të tyre dhe kudo ku ata shkonin hapnin shtigje të reja të qytetërimit.

Në Shqipëri me gjithë kundërshtimet e Perandorisë Osmane në fund të vitit 1857 arritën të hapnin Seminarin e Parë Papnuer Shqiptarë (në Shkodër). Kështu ardhja e jezuitëve shënoi pikënisjen e një rilindje të jetës fetare, kulturore e arsimore në Shqipëri. Misionarët e parë italianë që erdhën në Shkodër u njësuat aq shumë në popull sa që për ta Shqipëria u bë atdheu i tyre I dytë.

Duke qenë se pozicioni gjeografik i vendit tonë përfshihej mes lindjes e perëndimit, ka kushtëzuar ndikime të shumta në çdo drejtim e prej çdo periudhe të ndryshme historike. Pavarësisht mungesës së shumtë të dokumentacioneve mbi muzikën e instrumentet duket se rreth shek. XI – XII në shërbesat fetare ka mbizotëruar kënga gregoriane .Këto që përmendim janë fakte të mbështetura mbi studime e zbulime të ndryshme arkeologjike e sidomos të disa instrumenteve (organo) që mendohen kanë qenë funksionale nëpër kisha qysh para pushtimeve osmane (Kisha e Shën Shtjefnit, Kalaja e Shkodrës ka pasur një organo të tillë).

Siç thamë më lart me ardhjen e jezuitëve në Shkodër u çel periudha e një rilindjeje të re të jetës fetare – kulturore – arsimore të qytetit.

Në vitin 1876 At Gabriel Musatti i shoqërisë së Jezusite, hapi për here të parë një shkollë muzike (filllore) ku u përgatitën koristët e parë për koret e Kishave e Katedraleve dhe Kongregacionit të Zojës Nunciatë ku drejtuesit e saj kishin porositur instrumente muzikore dhe më vonë ato zhvilluan manifestime të ndryshme muzikore në qytet.

Të gjithë nxënësit instrumentistë e koristë filluan të luanin me nota muzikore duke hedhur kështu hapat e parë të artit muzikor profesionist.

Në orkestrën e krijuar filluan të luanin edhe vetë jezuitët si At Luigj Massa, At Karlo Vasilika (të cilët i binin violinave). Kështu një kongresist tjetër i binte klarinetës, flautist, etj, duke bërë kështu të lindnin gradualisht edhe zërat e përpunuar të fëmijëve bass, baritone, alto, soprano etj .Krahas veprimtarive të ndryshme të grupeve – artistike të Kongregacionit të Zojës Nunciatë veprimtari të rëndësishme të zhvilluara në këtë periudhë dhe nxënësit e kolegjit – Saverian ku rëndësi të madhe luante koncerti i

shpërndarjes së dëftesave. Për të gjykua mbi këtë aktivitet poetiko – muzikor kemi këtu edhe programin artistik që u zhvillua në vitin shkollor 1902.

Gjatë viteve 1931 – 1936 zhvilluan veprimtarinë e saj edhe Fanfara e Jetimores e drejtuar nga etërit – Jezuitë. Me një numër prej 20 instrumentistësh, ajo udhëhiqej nga mësuesi i muzikës së kolegjit prej nga varej edhe jetimorja.

Megjithëse veprimtaria e saj ka karakter të qëndrueshëm aktiviteti i saj (bandës) rrallë I kalonte muret e shkollës.

Edhe rrethi I Don Boskos I drejtuar nga etërit – Jezuitë vunë në skenë shumë vepra teatrore e muzikore por rëndësi më të madhe i kushtuan teatrit duke u marrë me përkthime e vënie në skenë të dramave për fëmijë.

Një tjetër moment i rëndësishëm në jetën artistike të shkollës është dhe himni i Kolegjit Saverian me muzikë të At' Gjon Pedronit (jezuit) dhe tekst të D. Lazer Shantojës i cili në përmbajtje të tij përshkruhet nga nota të forta patriotike dhe edukative gjë që përbën boshtin kryesor të punës së shkollës tone që nga krijimi i sajë e deri më sot.

*Na djemt e Kastriotit*

*Sizana malit*

*Mbledhun këtu jena*

*Mbas një idealit*

*Kemn'flamur të shkrume*

*Tri fjalë të prarume*

*PËR ZOT PËR ATME E PËRPARIM, etj*

### Personalitete të rëndësishme

Në kujtimet e tij P. Luciano Fozzer i cili ishte në Shqipëri si misionar në vitet 1938 – 1940 (dhe sot ai është rreth moshës 99 vjeçare) shprehet se: - Kur erdha në Shqipëri ishim në prag të luftës dhe mësuesit e seminarit që mësonin muzikë vinin nga jashtë bile N/drejtori P. Andreini punoi shumë me bandën frymore të shkollës. Kjo ishte periudha kur në bankat e shkollës ishin ulur si nxënës personalitetet e ardhshme shqiptare si M. Koliqi, N. Mjeda, L. Gurakuqi, H. Mosi, E. Koliqi, A. Pipa, F. Konica, T. Harapi, etj.

Në kujtimet e tij ish-nxënësi i kësaj shkolle muzikanti Henrik Doragjati kujton se në koncertet që organizoheshin pianist shumë i mirë ishte P. Cornolo, person me shumë autoritet (qe karakteristik kishte llullën me cigare që kurrë nuk e hiqte nga goja) si dhe fratel Bojati që ishte gjithashtu një personalitet tjetër shumë i aftë i muzikës në këtë kolegji. Nuk mund të lëmë pa përmendur këtu edhe etërit e “Misiuone Volante” që krahas punës së tyre tepër të vështirë në

zona të thella malore (në pajtime gjaqesh) etj, u mësonin besimtarëve shumë këngë të bukura të cilat qarkullonin kaq shumë në popull sa në një kohë shumë të shkurtër ata u bënë të njohura për të gjithë zonën, e shoqëroheshin me firzamonikë nga fratelat e shkollës që sigurisht ndër ta më i përgatituri ishte fratel Pantelia i cili gëzonte respektin e simpatinë e të gjithëve për talentin e virtytet e tija të rralla...

### Periudha të vështira

Me ardhjen e regjimit komunist në Shqipëri filloj “kalvari” i vuajtjeve i të gjithë klerik katolik viktimë e së cilës ishin edhe etërit – jezuitë. Kjo ishte periudha më e vështirë e një shkatërrimi total të vlerave artistike – kulturore të një vendi e kombi dhe hyrja e tij në periudhën e ashtuquajtur “Realizmi Socialist” e “Njeriut tonë të ri” etj. Pre e këtij gjenocidi ishte edhe Kardinali i parë shqiptarë Mikel Koliqi i cili u dënua me 40 vjet si klerik, euridit, muzikant, poet etj. Dom M. Koliqi kishte njohuri maksimale për muzikën pasi vetë luante shkëlqyeshëm në pianoforte...

Ai hapi dhe drejtoj për herë të parë korin “Schuola Contorum” ku këndohej me katër zëra. Filluan këndimet e para të “Koralit Gregorian”. Ai kompozoi shumë vepra korale si “Cor – Jezu”, “Sacerdotus Domii”, “Bari i Betlehemit”, etj.. Ndërroi jetë në moshën 95 vjeçare pas emërimit nga Papa Gjon Pali i II si Cardinali i Parë Shqiptar. Një personalitet tjetër i botës së muzikës i etërve – jezuitë është Ndre Mjeda. Në vitin 1887 – 1891 ishte profesor muzike në Kolegjin Vida – Kremona – Itali. Në atë kohë Kremona ishte një qendër e famshme artistike e muzikës klasike italiane. Qyteti njihej për prodhimin e instrumenteve muzikorë violinave (stradivari) si dhe pianoforteve më të mira të kohës.



Me ardhjen e tij në Shkodër ai bëhet pjesëtar i grupeve artistike të qytetit sigurisht me instrumentin e tij (violinës) duke marrë pjesë në shumë aktivitete krahas muzikantëve më të mirë të kohës.... Ai ishte edhe një poet i famshëm që vargun e tij poetik (melodios) ashtu siç thotë dhe vetë studiuesi i tij pasionant M. Quku i vinte nga vetë muzika që ai e njihte shumë mirë.

Këto ishin disa personalitete e ngjarje historike të lidhjes së jezuitëve me muzikën që sigurisht përbën një bazë të gjerë të traditës së historisë të gjimnazit tonë At Pjetër Meshkalla në mbështetje të së cilës vazhdon rrugën e padiskutueshme të rritjes së saj profesionale dhe edukative falë stafit pedagogjik e nxënësve të cilët përbushin çdo ditë detyrat e rezultatet që i kanë ngarkuar vetes për të çuar përpara shkollën e për të mbajtur gjallë traditën e saj të shkëlqyer.

### Aktiviteti

Me datë 13 – 16 Prill 2011 në Messina të Italisë në kuadrin e edicionit të XXVIII të projektit “Jezuitë e Historia” u zhvillua takimi vjetor me temë “Jezuitët e muzika” organizuar në Kolegjin S. Injazio di Loyla. Në të morën pjesë delegacione të ndryshme nga shkolla si Milano, Torino, Roma, Polonia, Spanja, Palermo e Shqipëria.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë edhe nxënës të gjimnazit tonë At Pjetër Meshkalla të cilët diskutuan mbi lidhjen e jezuitëve me muzikën që nga periudha e ardhjes së tyre në Shqipëri e deri në ditët e sotme.

Seminari i zhvilloi me sukses punimet e shkolla jonë si gjithmonë doli me konsideratat më të mira për përgatitjen e nivelit të tyre të përfaqësimit.


Mbi të gjitha ra në sy historia shumë e dhimbshme e popullit shqiptar që sigurisht pre e këtij kalvari ishin edhe etërit – jezuitë, por mbi të gjitha ashtu siç u shpreh edhe Padre Eugenio Costa (ekspert i muzikës e teologjisë) tha: “ Historia juaj është shumë e dhimbshme por shumë edukative. Ju keni çfarë tu tregoni brezave që vijnë. Urime dhe komplimentet më të mira për shkollën tuaj e stafin pedagogjik të saj”. Aktiviteti përfundoi me sukses, punimet dhe me nxënës dhe mësues u kthyem me eksperiencë të re pranë shkollës sonë duke marrë edhe përgëzimet e kolegëve e drejtuesve të saj.

**Dr. Tonin Çobani**  
Tiranë

## MITOLOGJIA NË LAHUTËN E MALCIS

“Pa mitin, çdo kulturë e humbet karakterin e saj të gjallë krijues, humbet forcën e vet të natyrshme”  
FRIEDRICH NIETZSCHE

**Libri “LAHUTA E MALCIS, Ngjizja mitologjike dhe Fjalori i figurave mitologjike”, QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2012.**




### 1.

Fishta, kur nisi aventurën letrare për të krijuar eposin artistik të popullit shqiptar, përcaktoi objektivin e saj, që ishte Marash Uci e të bijtë e Calëve; konfliktin e tyre me krajl Nikollën e Cetinës e carët e Moskovit, me sulltanin e Stambollit e regjët e Evropës. Ai zgjodhi tetërokëshin dhe, për të kënduar së bashku me të në *Lahutë të Malcis*, thirri një Zanë, që ne e kemi quajtur konvencionalisht Zana e Frymëzimit. Do të kishte mjaftuar ajo figurë mitologjike, e pranishme në të gjithë episodet e veprës, për të dëshmuar ngjizjen mitologjike të *Lahutës së Malcis*. Por jo vetëm kaq. Figura e Zanës së Frymëzimit na sugjeron të dallojmë originalitetin epik të Fishtës, lirizmin në *Lahutë të Malcis*, ironinë dhe, veçanërisht, lehtësinë e rrëshqitjes së poetit nga realja tek jorealja e anasjelltas, gjëra që përbëjnë përgjithësisht magjinë e verbit fishtjan. Por Fishta nuk u mjaftua vetëm me krijimin e Zanës së Frymëzimit. Ai krijoi edhe personazhe të tjerë mitologjikë: Orën e Shqipërisë dhe Orë të tjera, Zanën e Madhe dhe Zana të tjera, Dragonjtë e Kuçedrën, Lugetërit, Shtrigat, Floçkën. Të gjitha këto figura përbëjnë shtratin mitologjik të *Lahutës së Malcis*: kënga e 11-të mban titullin “Lugati”, sikundër e 16-ta “Kuçedra” dhe e 24-ta “Zana e Vizitorit”. Edhe “Gjaku i marrun” e “Koha e re” (këngët 25, 26) e ndonjë tjetër u kushtohen krejtësisht ose pjesërisht Shtojzovalleve, të cilat janë të kudogjendura në vepër, shpesh herë së bashku me figura të tjera mitologjike.

### 2.

Në kapërcyell të shekujve XIX-XX apo, më saktë, në fillim shekullin e 20-të kur zë fill *Lahuta e*

*Malcis* dhe Fishta këndon mitet e lashta, gjuha shqipe gjallonte e pamësuar nëpër shkolla, nocioni shqiptarizëm qarkullonte kryesisht ndër intelektualë atdhetarë të diasporës, të cilët deri atëherë kishin krijuar një letërsi të konsiderueshme në gjuhën amtare. Në mungesë të letërsisë së kultivuar, në popull gjallonte një letërsi e pasur gojore ku elementet fantastikë dhe figurat mitologjike bashkëjetonin besueshëm me figura historike të së kaluarës së largët e të afërme. Kështu, besohej se Skënderbeu dhe Lekë Dukagjini kishin lindur Dragonj, ashtu si konsiderohej Dragua edhe një hero i ditës si Mehmet Shpendi, që luftonte maleve për mbrojtjen e trojeve shqiptare prej



shovinistëve sllavë. Kjo mendësi vinte deri në Shkodër, qyteti më i madh në Ballkan i Perandorisë Osmane, ku ishte krijuar një bërthamë intelektualësh me kulturë evropiane-perëndimore që inspironte Rilindjen Kombëtare. Duhet shtuar se, së bashku me besime popullore, bashkëjetonin edhe besëtytni të importuara orientale. Në këtë realitet të përzier fantazish, Fishta këndon mitologjinë thjeshtë shqiptare, atë që rridhte prej bjeshkëve të larta ku historia ishte ende mit dhe miti përjetohej çdo ditë si realitet epik.

### 3.

Kur shkruhej *Lahuta e Malcis*, në të cilën fillesa mitologjike zë vend të rëndësishëm në strukturën e veprës, komunikimi i intelektualëve me kombin nuk ishte i lehtë. Shqiptarët, pothuajse në masë, nuk dinin të shkruanin dhe të lexonin në gjuhën e tyre. Gjithçka që krijohej në shqip botohej thujse e gjitha në diasporë. Edhe Fishta fillimet letrare i ka te revista "Albania" e Faik Konicës që botohej në Bruksel. Madje edhe bleni i parë i *Lahutës së Malcis* u shtyp me ndërmjetësinë e Faik Konicës në Kroaci me 1904-5. Fishta nënshkroi me pseudonimin "Kangë Popullore", sepse orientimi i veprës së tij ishte vërtetë për popullin shqiptar, përfshirë edhe atë masë që nuk dinte shkrim e këndim, por jetonte estetikisht kohët mitike. *Lahuta e Malcis* do të "lexohej" pak a shumë si këngë folklorike, duke qarkulluar gojë më gojë. Ky fakt duhet konsideruar risi letrare e guxim artistik

në letrat shqipe, një gjetje që përbën kyçin e suksesit të veprës *Lahuta e Malcis*, së cilës Fishta ia dha dorën përfundimtare më 1937. Të shprehemi qartë: jo folklorizmi përbën risinë dhe kyçin e suksesit të një vepre letrare, si janë shprehur shpesh herë edhe në mënyre spekulative për eposin fishtjan. Por komunikimi i fuqishëm ideo-emocional i një vepre letrare me të gjitha shtresat e shoqërisë, duke filluar nga intelektualë të shquar të kohës si Lasgush Poradeci e Eqrem Çabej, që me gjuhën e Umberto Ekos do të cilësoheshin "Lexues model të nivelit të dytë", e deri tek ai bariu, "lexues" i nivelit të parë, që nuk dinte shkrim e këndim, por e ndjente bukurinë e fjalës shqipe që të ngazëllen e të shiton si pingërimë Zanash.

### 4.

Na duhet të theksojmë se edhe areali i figurave mitologjike në *Lahutë të Malcis* nuk është folklorizëm, sado që derisa Fishta i rikrijoi në veprën e tij, qeniet mitologjike ekzistonin vetëm në folklor e në besime popullore. Kulti i Zanave, p.sh., është ruajtur i gjallë, si mbijetojë e një Panteoni të hershëm mitologjik të bashkësisë fshatare ndër male "deri në shekullin XIX e në fillim të shekullit XX, aty-këtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore". Madje kulti i Zanave në Shqipëri është edhe shumë më i hershëm se sa është menduar prej atyre që e kanë përafuar me Dianën e romakëve, e cila kishte marrë atributet e Artemidës së grekëve. Çabej shkruante se te "kjo Diana kemi të bëjmë me një



“interpretatio latina” të një hyjnie epikore (vendore) pararomake”. Kështu mund të flitet edhe për Floçkën e Ranës së Hedhun që del në *Lahutë të Malcis* si një mit i etnogjenezës së stërlashtë të rodit të shqiptarit, si dhe për Dragonjtë, gjithashtu, dëshmi të prejardhjes mitologjike pellazgo-ilire, të cilët vijnë në veprën e Fishtës me përmbajtjen simbolike të ndryshme ose më të hershme se përmbajtja simbolike që ata demonë kishin marrë në epokën antike greko-romake e biblike.

##### 5.

“Ndryshe” i ka sjellë në letërsinë e shkruar shqipe edhe Pjetër Bogdanin (1630-1689) të dhjetë Sibat e ciklit të poezive kushtuar atyre në veprën madhore *Cuneus Prophetarum* (Çeta e Profetëve, 1685). Madje ai edhe i ka shqiptarizuar Sibat, figurat parakristiane të mitologjisë mesdhetare,



duke u vënë emra krahinash arbërore, si: Shkodranja, Zadrimorja, Kosovarja etj. Bogdani shkruante se kishte dashur t'i veshte Sibat me kostume shqiptare “për të dhënë ngjyrën e atij populli të varfër dhe për t'i ngushëlluar sa kam pasur mundësinë”. Ndërsa Fishta këndon Zanat, Dragonjtë... si një pasuri të rrallë e deri atëherë të palançar të kulturës shqiptare, pasi kishte bërë të vetin parimin e Niçes se “pa mitin, çdo kulturë e humbet karakterin e saj të gjallë krijues, humbet forcën e vet të natyrshme, sepse horizonti i artit hapet vetëm përmes mitit, është ai që e bën të jetë një, të jetë unik”. Nga ana tjetër, ai nuk kërkoi mite të njohura si Sibat për të shqiptarizuar e as për të shartuar, ndoshta, nisur përsëri nga një parimi tjetër i Niçes që thoshte: “Nuk është e lehtë të shartosh një mit të huaj me tëndin, pa dëmtuar bimën amë, ndodh që druri të jetë aq i fortë dhe i shëndetshëm,

saqë s'kalon shumë dhe e largon të huajën nga vetja, por si rregull, ajo vetë fishket e thahet, vdes.” Më në fund duhet thënë se Fishta u kundërvihet pseudointelektualëve të kohës e më përtej, pasi ka vënë re se “kulimllëku vagabond-modern (shqiptar) kërvësh buzët mbi thjeshtësinë e artë të mitologjisë sonë kombëtare”, si shkruan ai në vitin 1933 në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

##### 6.

E gjithë lënda mitologjike, me të cilën u mbryjt *Lahuta e Malcis* është vetëm shqiptare dhe krejtësisht pagane. Ajo mitologji ka ekzistuar paralel me mitologjinë greko-romake e biblike, ashtu si gjuha shqipe është zhvilluar paralel me gjuhën greke, romake e latino-kishtarë. Mitologjia shqiptare ka mbijetuar përgjithësisht e pandikuar nga mitologjia greko-romake e biblike ashtu si rodi i shqiptarit kishte mbijetuar struktur thellësive të maleve, së paku, deri në kohën kur shkruhej *Lahuta e Malcis* gjatë viteve 1902-1937. Në qoftë se do të përdornim formulimin e studiuesit Krist Maloki, që përfaqëson këndvështrimin psikanalist në kritikën letrare shqiptare, do të gjenim te Fishta poetin që “ka



hulumtue e gërmue ner minat e shpirtit të kombit Shqiptar... ka zdytë fellë e ma fellë kah gurrat e fshehta të shpirtsisë natyrore arbërore... kah shpella e magjishme t'Orëve, Zanave dhe Shtojzovalleve të një mystike të përvëlueshme”.

#### 7.

Sado që Fishta e fillon *Lahutën e Malcis* me vargun “*Ndihmo Zot si m'ke ndihmue...*” dhe e mbyll me dyvargëshin “*Si premtue kish Perëndia, prapë zonjë n'veti duel Shqipnia*”; sado që në atë vepër togfjalëshi “*për Atme e Fe*”, që ishte programi ideologjik i klerit françeskan në Shqipëri, përsëritet herë pas here, *Lahuta e Malcis* është cilësuar pak a shumë si vepër laike. Në këtë përfundim nuk kanë arritur studiuesit ateistë, çfarë mund të merrej si një konkluzion tendencioz. Një formulim të tillë e ka bërë kolegu i tij, jezuit at Zef Valentini, studiues i vëmendshëm i *Lahutës së Malcis* dhe një ndër njohësit më të mirë të historisë, kulturës dhe letërsisë së gropës së Shkodrës e më gjerë. Ai shkruan më 1973 te revista *Shejzat* se “*Fishta ka qenë midis misionarëve më të lartë katolikë që shërbyen aso kohe në Shqipëri, por - shton Valentini - sot ka ardhur koha të flitet qartë*

*edhe për një lloj afetarizmi të kryeveprës së tij Lahuta e Malcis*”. Valentini nuk e argumenton mendimin e shprehur, por ne mendojmë se argument i mjaftueshëm për të arritur në një përfundim të tillë është fakti se mitologjia e *Lahutës së Malcis* nuk ka marrë thujasë asgjë nga mitologjia biblike, çfarë do t'i shkonte një vepre të shkruar nga një klerik, ajo nuk ka marrë as nga mitologjia greko-romake, çfarë do t'i shkonte një autori që kishte studiuar me themel në gjuhët origjinale letërsinë e vjetër greke dhe atë latine.

#### 8.

Studimet e deritanishme e kanë shpërfillur shpesh herë “subjektin mitologjik” të *Lahutës së Malcis* ose e kanë trajtuar si një fillesë artistike të dorës së dytë a të tretë, duke i kushtuar vëmendje të merituar vlerave të tjera përmbajtjesore dhe artistike që nuk janë të pakta në vepër. Madje, ndonjë studiues i sotëm arrin në konkluzione jo të qëndrueshme duke e quajtur *Lahutën e Malcisë* “të shpallur ep religjioz”, përkundrajt klasifikimeve të derisotme si epos klasik apo heroiko-pastoral, poemë epike apo edhe epiko-lirike. Kjo ka ndodhur pikërisht se është shpërfillur lënda mitologjike e

veprës, e cila jo vetëm shtrihet dukshëm në një të pestën e veprës (tërësisht në këngët “Lugati”, “Kuçedra”, “Zana e Vizitorit”, “Gjaku i marrun”, “Koha e Re” dhe pjesërisht në shumë këngë të tjera), por edhe sepse ajo lëndë përbën indin kompozicional të të gjithë veprës, pasi siguron vijimësinë e episodeve dhe unitetin e tyre. Nëse do të studiohet *Lahuta e Malcis* thjeshtë si një ngjizje epike e periudhës së romantizmit të vonë në Ballkan, atëherë do të arsyetohej më bindshëm edhe lënda historike në të, ashtu e përzier me figurat mitologjike dhe e mbrujtur me një gjuhë të gjallë dhe të pasur popullore; do të konkludohej më saktë për llojin e epikës fishtjane të shpallur apo të pashpallur; do të arriheshin edhe shumë konkluzione të qëndrueshme për individualitetin krijues të autorit të saj që tashmë është kthyer në model klasik të letrave shqipe.

### 9.

Fakti që figurat mitologjike shqiptare vijnë fuqishëm në letërsinë e shkruar shqiptare kaq vonë, në fillimshekullin XX, nuk duhet paragjykuar si “një fenomen i vonuar në letërsi”, krahasuar me letërsinë e vendeve të zhvilluara, përfshirë, p.sh., letërsinë dhe kulturën gjermane me Richard Wagnerin (1813-1883), shkrimtar dhe kompozitor i shquar i romantizmit evropian, veprat e të cilit ishin rikrijim i subjekteve dhe figurave mitologjike gjermanike, veçanërisht, të eposit të Nibelungëve. Ndikimi i Wagnerit të Fishta, po të studiohej me atë qëllim, do të dilte shumë më i dukshëm se sa përafërsitë e *Lahutës së Malcis* me eposin homerik (apo virgjilian), gjë që është rrekur të argumentojë albanologu austriak Maksimilian Lambertz e të tjerë pas tij. Aq më pak, do t'i shkonte kujt ndër mend të penalizonte Fishtën dhe letërsinë shqiptare të përfaqësuar prej tij, si një letërsi folklorizante, gati-gati duke pëshpëritur nën zë për *Lahutën e Malcis*: më mirë të mos ishte shkruar fare, se na ka veçuar prej rrjedhave bashkëkohore të letërsisë evropiano-perëndimore. Për ndryshe, duke e pranuar Lahutën e Malcis si një vepër të fundit të romantizmit evropian dhe, me këtë këndvështrim, duke arsyetuar edhe mitologjizmin e saj dhe mbështetjen aktive në folklor, si një vlerë të mirëfilltë artistike, gjykimet tona

do të mbeteshin më realiste, qoftë porsa i përket vendit që zë ajo vepër në hapësirat e letërsisë shqiptare, qoftë në rrafshin krahasues me zhvillimet e letrave evropiane. Mund të kujtojmë këtu se në vitin 1906, kur Fishta niste botimin e *Lahutës së Malcis* (më 1904-5 botohet cikli i këngëve të Marash Ucit dhe më 1907 cikli i këngëve të Oso Kukës, që i bie afërsisht një e treta e veprës) në Evropë vlerësohej me Çmimin Nobel italian i Karduçi (1835-1907), që në vendin e tij konsiderohej poeti i fundit romantik në Evropë. Në një këndvështrim më të guximshëm, për shfrytëzimin e miteve nga Fishta dhe rikrijimin e tyre, sipas modeleve të letërsisë gojore, mund të shtonim se ai ishte në të njëjtën paralele me zhvillimet estetike evropiane të kohës së tij. Autori i *Lahutës së Malcis* ishte në vazhden e atyre shkrimtarëve romantikë, për të cilët është thënë se “në krijimtarinë e tyre pati gjallërim edhe një lloj mitologjizmi i ri, i cili i parapriu mitologjizmit modernist”.



**Dom Nikë Ukgjini**

Instituti Filozofik dhe Teologjik-Shkodër

## AUSTRO-HUNGARIA - KISHA KATOLIKE DHE PAVARËSIA E SHQIPËRISË 1912

(Pjesa e fundit)

*Konference Shkencore: Shqipëria 100 vjet Pavarësi. Marrëdhëniet Shqiptaro-Austriake  
Tiranë, 16-19 tetor 2012, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ambasada Austriake.*



### Protektoratit fetar i Perandorisë Austro-Hungareze

Pas vendosje së sundimit të egër osman, në shek. XV-XVI, kisha katolike, më gjithë tronditjen dhe dëmtimet që pësoi, jo vetëm që nuk u zhduk, por u përpoq ta ruante dhe të forconte organizimin e mëparshëm në kushte të reja të këtij sundimi anadollak.

Kryedioqeza e Tivarit vazhdonte edhe gjatë shek. XVI deri në gjysmën e shek. XIX, të ishte kryeqendër e kishës katolike dhe, ndërmjetëse e rëndësishme, në mes të Papatit dhe kishës lokale, në trevat shqiptare si: kryedioqezës së Durrësit e Shkupit dhe dioqezave të: Shkodrës, Lezhës, Pultit dhe Sapës.

Ndërlidhjet kishtarë dhe ato diplomatike në mes

ipeshkvijve të Shkodrës, si qendra më e rëndësishme shqiptare, me institucione të tjera fetare e diplomatike, zhvilloheshin nëpërmjet Propaganda Fides në Romë, Nuncit Apostolik në Vjenë, Ambasadorit të Perandorisë Austro-Hungareze, në Romë dhe Kostandinopojë, Patriarkut të Arzeneve në Kostandinopojë, si ndërmjetësuese në mes papatit, Perandorisë Osmane dhe Konsullatës Austro-Hungareze, në Shkodër.

Meqenëse Austria, nëpërmjet traktateve të shumta kishte arritur një rezultat më të mirë: atë të një protektorati fetar, në krahasim me Francën, klerikët qenë drejtuar për ndihmë dhe bashkëpunim Perandorisë Austriake, përkatësisht asaj Austro-Hungareze.

Vënia në lëvizje e protektoratit fetar të Perandorisë Austriake, në lidhje me shqiptarët, shënohet me rastin e vizitës së ipeshkvit të Shkodrës, Imzot Benjanin Albertinit, në Romë, në vitin 1836, dhe vizitës së tij, po atë vit, tek perandori Austro-Hungarez, Franc Jozef i I, në Vjenë. Si rezultat i këtij takimi që, nënshkrimi i marrëveshjes së vitit 1837, në mes dy palëve, ku Austro-Hungaria do të merrte me anën e një dekreti nga Papatit, të drejtën për t'u kujdesur për Kishën katolike në trevat shqiptare. Ngritja e marrëdhënieve mes Romës dhe Vjenës, në vitin 1855, në rangun e Konkordatit, do të thellonte dhe më tepër marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në mes hierarkisë së lartë kishtarë dhe Perandorisë dualiste.

Plani i përfolur në Shkodër dhe në Romë, gjatë viteve 1887-1893, për nënshkrimin e një Konkordati në mes Romës dhe Stambollit, ku do përfshihej dhe çështja shqiptare, sipas korrespondencës së kryepeshkvit të Shkodrës, Pasquale Guerrini dhe Propaganda Fides, Kardinalit Lodochovskit, nuk qe realizuar. Kjo edhe për faktin se Perandoria Austro-Hungareze, gjatë zhvillimit të bisedimeve kërcënonte në prishjen e marrëdhënieve diplomatike me Vatikanin.

Gjendja kishtarë në dioqezat shqiptare, gjatë pushtimeve osmane, sa vinte e rëndohej. Kjo si



pasoje e persekutimeve, mungesës së klerit, mangësisë së zhvillimit të edukatës fetare pranë kishave, shkatërrimit të shumë prej kishave dhe Katedraleve etj..

Po ashtu ndikim në varfërimin e jetës së popullsisë shqiptare, patën dhe taksat e vendosura nga autoritet pushtuese, në kurriz të popullsisë së krishterë e shumë të tjera.

Parë në këndvështrimin e situatës tepër të vështirë të institucioneve katolike në trojet shqiptare, protektorati i kultit ishte një shans i mirë për rimëkëmbjen dhe mbrojtjen e popullatës katolike ndaj abuzimeve të autoriteteve osmane dhe për nxitjen e investimeve në fushën fetare, kulturore, ekonomike; (në heshtje) dhe në fushën politike.

### **Ndërtimi i selive kryeipeshkvore**

#### **Kryeipeshkvia e Shkodrës**

Kontaktet e mirëfillta në mes të Perandorisë Austriake dhe dioqezës së Shkodrës, sipas arkivit të vitit 1826 të kësaj dioqeze, ishin gjallëruar në kohën e ipeshkvit Albertini në vitin 1832. Me ardhjen e tij në krye të kësaj selie, është relacioni i parë, në vitin 1833, dërguar nga Propaganda Fide në Romë, ku përshkruhet gjendja e vështirë fetare dhe politike në Shkodër dhe në dioqezën e Pultit. Një relacion i ngjashëm, por më i zgjeruar, duke përfshirë, historikun e këtyre dioqezave, gjendjes e popullatës shqiptare, mungesës së një kisha Katedrale në Shkodër dhe nevojën për ndihma sociale, Albertini, kishte prezantuar para qeverisë së Vjenës më 6. 7. 1837, me rastin e një vizite zyrtare tek perandori Franc Jozefi I. Si rezultat i këtij takimi, qenë dhe ndihmat e vazhdueshme të kësaj perandorie, për nevojat e ndryshme si dhe mbledhja e fondeve për ndërtimin e Katedrales së Shkodrës, e cila u inaugurua në kohën e Liugji Çurçisë, në praninë e valiut të Shkodrës, Ismail Pashës si edhe të autoriteteve të tjera konsullore, në vitin 1865. Si rezultat i takimit në Vjenë, vinte dhe informacioni i Propaganda Fides në Romë, dërguar në vitin 1842, ipeshkvit të Shkodrës, Liugji Guielmo, për dekret - marrëveshjen e protokultit, për shqiptarët nën Perandorinë Osmane, të nënshkruar në mes të Papatit dhe të kësaj Perandorie.

Pasi selitë ipeshkvore ishin simbol i fuqizimit të kishës katolike në trevat e pushtuara, Qeveria Austriake, do të vazhdonte të ndihmonte në ndërtimin e katedraleve dhe në dioqeza të tjera.

#### **Kryeipeshkvia e Shkupit**

Nga një qarkore e Imzot Pashko Trokshit, mund të kuptojmë se Kisha Katedrale e mëparshme e Shkupit, ka qenë kushtuar “Zojes se Bekuem” (Nenës se Jezu Krishtit), ndërsa, ajo e reja që ndërtuar në vitin 1902 nga kryeipeshkvi Trokshi dhe kushtuar “Zemrës se Krishtit”.

Meqenëse, Perandoria Osmane, nuk lejonte që ipeshkvijtë të banonin në qendrat e tyre rezidenciale, ata u detyronin që grigjën e tyre ta udhëheqësin nga selit e tyre dytësorë. Në kohën e kryeipeshkvit të Shkupit, Dario Bucciareli, në Prizren, në vitin 1875 që ndërtuar Kisha konkatedrale, kushtuar “Zojes se Bekueme”, si dhe disa kisha të vogla në fshatrat përreth, të financuara nga Perandoria Austro-Hungareze. Kurse, më herët, në viti 1866 e në vazhdim, pranë kishave apo shtëpive famullitare, funksionin disa shkolla, ku mësohej gjuha shqipe, si në: Prizren, Gjakovë, Pejë, Zymb, dhe Janjevë.

#### **Kryeipshvia e Durrësit**

Në Tiranë, gjatë kohës së kryeipeshkvit, të Durrësit, Rafaele D'Ambrosio, me seli në Delbnisht, më shpenzimet personale të Franz Jozefi, që ndërtuar Kisha e “Zojës së Paplyeme”, e cila që inauguruar në vitin 1857, dhe në kabanoren e saj pranë kryqit të hekurt, valonte flamuri më stemën e Perandorisë Austriake. Kurse, disa vite më vonë në truallin kryeipeshkvore në Durrës, në vitin 1868 që ndërtuar një Kishë e vogël, kushtuar Shën Luçise e cila luante rolin e konkatedrales. Në vitin 1872, pranë kishave, funksionin 2 shkolla femërore, ndërsa në vitin 1877 ishin hapur 5 shkolla mashkullore, ku mësohej edhe gjuha shqipe. Në këto shkolla edukoheshin fëmijët e tri besimeve.

#### **Kryeipeshkvia e Tivarit dhe Carlo Pooten**

Më kryedioqezën e Tivarit, seli edhe e Primatit të Serbisë, qeveria Austriake do të luante një rol të rëndësishme fetar dhe diplomatik. Ajo, duke u mbështetur në të drejtën e Protektoratit të Kultit, për emërimin e ipeshkvijve, pas shkodranit Vincenc Batuçit, në krye të kësaj Selie, solli, vizionarin e spikatur, gjermanin Karlo Pooten (1844-1886) nga Tevereni, Kryedioqeza e Këlnit.

Imzot Pooten, meqenëse dhe më parë ishte marrë me punë diplomatike, shquhej si njohës i mirë i çështjeve ballkanike dhe, njëherazi, ishte mik i ngushtë i princit Maksimilian, vëllait të mbretit Franz Jozef I.

Për dallim nga paraardhësit e tij, të cilët pushteti



turk nuk i lejoji të qëndronin në Tivar, por në Ljare të Shestanit, Pooten, arriti që ta udhëhiqte kryedioqezën, nga ky qytet i lashtë, pikërisht nga Gretva e Tivarit, ku në vitin 1846, me ndihmën e Perandorisë, ndërtoi Selinë kryeipeshkvnore dhe më 8 dhjetor të vitit 1857, në lokalitetin Gretva, përfundoi edhe ndërtimin e Katedrales së Tivarit, kushtuar “Zojës së Bekuar të Papërlyer”. Ndër dorëshkrimet e tija të shumta ende të pabotuara, vlen për t'u veçuar korrespondenca e tij me mbretin Nikolla i I-parë i Malit të Zi, në vitet, 1862-1863, ku, Pooten ndër të tjera, proteston ashpër, ndaj abuzimeve nga ana e ortodoksëve me varrezat katolike në Podgoricë, djegien e Kishës në Shestan dhe padrejtësive tjera që bëheshin ndaj katolikeve. Rreth kësaj çështje njofton dhe guvernatorin e turk dhe konsullatën austriake në Shkodër. Vlen për t'u veçuar dhe letra e Pooten, dërguar arkidukës Ferdinandit, për vitin e ri 1864, ku ndër të tjera falënderon për ndihmat për shkollën katolike dhe mësuësin e qytetit të Tivarit.

Pas paralajmërimeve për ndryshimet gjeopolitike në Ballkan, Pooten duke kuptuar mirë, rolin që në të kaluarën ka pasur Shkodra, si kryeqendër e Prevalitanes, dhe rrezikun që i kanosej

trevave shqiptare, ndërmoi hapa të guximshëm dhe largpamës, duke iu drejtuar papa Piut IX, me qëllim që dioqeza e Shkodrës të ngrihej në 'piemontin' e lartë kishtar, në Kryedioqeze.

Papati edhe pse, për shkak të marrëdhënieve jo të mira, me Perandorin Osmane dhe ortodoksin sllave pati mjaft vështirësi. Por, e gjetur nën presionin pozitiv të Perandorisë Dualiste, me dt, 15 mars të vitit 1867, lëshoi dekretin për bashkimin Tivarit, me dioqezën e Shkodrës, duke e shpallur këtë të fundit Kryedioqezë Metropolitane dhe Tivarin, varëse të saj.

Me këtë gjest, Pooten, do t'u rikthente Shkodrës dhe shqiptareve, dinjitetin dhe lavdinë që e mbanin në zemrat e tyre, që nga koha e mbretërisë Ardiane. Kjo ngritje në rangun më të lartë kishtar dhe diplomatik, do të thoshte, se Perandoria austro-hungareze, “de fakto” e kishte pranuar Shqipërinë si provincë në vete e me të drejtat e shpalljes së pavarësisë, duke përfshirë edhe trevat shqiptare në Mal të Zi, në një të afërme jo fort të largët.

#### **Pooten dhe Kryeipeshkëvia e Shkodrës**

Pooten, tani, kryeipeshkëv i Shkodrës dhe i Tivarit, me ndihmën e Austro-Hungarisë, përpiqej

për të rimëkëmbur kryedioqezën metropolitane në aspektin kishtar dhe atë kulturor. Në vitin 1871, në Shkodër, si delegat i papës, më synim të bashkimit të gjitha trojeve shqiptare do të mbante, Koncilin e dytë kishtar mbarëkombëtar. Gjatë veprimtarisë së tij në Shkodër, shënohet ringritja e shumë kishave si dhe hapja e shkollave në të gjitha trevat shqiptare dhe pasurimi i bibliotekave të tyre me 57000 libra të dërguar nga Propaganda Fide. Gjithashtu, në kohën e tij, në vitin 1870, që ngritur me ndihmën e Austro-Hungarisë, tipografia e parë në trevat shqiptare më emrin, shtypshkronja, “Zoja e Papërlyeme,” Kolegji Saverian i Jezuiteve, Shkodër, në vitin 1877, kuvendi i urdhrit, françeskan në 1870 Shkodër, si edhe më 1880 ai i Troshanit e shumë të tjera.

Pas vdekjes së tij, në vitin 1886, në Shkodër, ku edhe u varros në katedralen e këtij qyteti, gjërat sikur morën një drejtim tjetër. Mundësitë e kësaj kryedioqeze qenë mjaft të kufizuara. Mali i Zi, duke u shpallur Mbretëri e Pavarur në Kongresin e Berlinit të vitit 1878, arriti që Tivarit, t’ia rikthejë titullin e mëparshëm. Në këmbim të këtij lëshimi, Mali i Zi, i ofroi Papatit nënshkrimin e një Konkordati, gjë që u realizua, më 18 gusht të vitit 1886, si i pari me një shtet sllavo ortodoks. Konkordati famëkeq prej 14 nenesh, u ratifikua po në atë vit, nga papa Leonit XIII dhe knjaz Nikollës Petroviq I (1860-1918) i cili kishte krushqi me princin e Savojës, Viktor Emanuelin.

Nga këto momente, ëndrrat e shqiptareve për bashkimin e trojeve në veri të vendit do të shuheshin njëherë e përgjithmonë.

### **Pavarësia në dukje**

Perandoria osmane, me sundimin e saj të mbështetur mbi shariat e Kuran, kishte nxitur tek kleri katolik, si shtresa me e lartë intelektuale, kulmin e acarimit, fetar dhe politik.

Filozofi francez, Zhan Pol Sartër ka shkruar se “nuk mund të jesh intelektual po që se nuk zotëron, përveç dijes edhe guximin”. Nisur nga ky fakt, kleri katolik së bashku me kryebarijtë e tyre, (ipeshkvijtë), më popullsinë në veri të vendit, ndërmorën një varg aksionesh për organizimin e lëvizjeve kulturore dhe kryengritjeve të armatosura, gjatë shek. XIX. Lëvizjet dhe kryengritjet përmbanin karakteristika të mirëfillta me orientim mbarëkombëtar, duke e ngritur seriozisht çështjen fetare shqiptare në nivelin e një çështje të mirëfilltë nacionale në tryezat e diplomacisë evropiane.

### **Veprimtaria diplomatike e Imzot Guerrinit**

Shtimi i terrorit osman ndaj Veriut të Shqipërisë, nxiti klerikët katolikë në veri të vendit, që krahas, kërkesave për ndihma materiale dhe bisedimeve diplomatike me qarqet perëndimore, të zgjonin popullin në kryengritje për çlirimin e vendit nga robëria e egër osmane. Bartës i aksioneve të kryengritjeve si edhe të bisedimeve diplomatike, sipas arkivit të kryedioqezës së Shkodrës, ishte kryeipeshkvi Pashk Guerrini, me prejardhje shqiptare nga Kotorri.

Lëvizjet e Malësorëve, për mbrojtjen e tërësisë territoriale, dalin në pah, në korrespondencën e kryeipeshkvit të Shkodrës, Patriarkut Armen dhe Propaganda Fide, që në vitin 1883 si dhe në vitin 1886, ku nga Patriarkut Armen, i kërkohej që, zyrtarisht, të ndërhynte tek Porta e Lartë, për ndalimin e dhunës që ushtrohej ndaj shqiptarëve katolikë nga Perandoria Osmane.

Në dos. 65, të vitit 1888, gjejmë dhe Promemorien e Guerinit, drejtuar, konsullatës austriake në Shkodër, për gjendjen e vështirë të popullatës në Shqipëri, si dhe për mundësitë për



zbutjen e kësaj situatë. Guerrini, çështjen nuk e lë me kaq. Në vitin 1892, personalisht merr rrugën për në Vjenë, duke u takuar më autoritet e larta perandorake, për t'i informuar për gjendjen në terren si dhe për rrugëdaljen nga kjo situatë shpërthyesë në popull.

Se lëvizjet e para shpërthyesë të mirë organizuara ishin në dukje, dëshmon dhe dos. 12, dt. 29, 8. 1903., ku Guerrini, përgjigjet Guvernatorit të Shkodrës, mbi ankesën e tij për organizimin e lëvizjeve për kryengritje të disave atdhetarëve malësorë.

Se sa dashuria dhe vetëmohimi ishin ngulitur në zemrat e tyre, edhe kur atdheu ndizej flakë, e tregon dhe fakti, që klerikët katolikë dhe patriotët, sipas Arkivit të Kryedioqezës së Shkodrës, në vitin 1904, haptazi, para nëpunësve të Perandorisë Osmane, kishin hedh idenë për kremtimin e 500 vjetorit të lindjes Skënderbeut dhe realizim e një medaljeje përkujtimore me këtë rast. (1404. 1904).

#### **Figurat, klerikale letrare dhe kryengritjet**

Në këto momente jetike për popullin tonë, në mesin e atyre të cilët, krahas veprimtarive të tyre botuese, jepnin përkrahje për qëndresën e vazhdueshme, dhe shquheshin si pjesëmarrës të ngjarjeve, ishin figurat e spikatura klerikale, letrare dhe kombëtare, si Abbat Preng Doçi, Dom Ndoc Nikaj, Dom Nikollë Kaçorri, poeti Ndre Mjeda, Atë Gjergj Fishta e shumë të tjerë.

Sipas dëshmimeve të shkruara të Dom Ndoc Nikajt, mbledhja e fshehtë e vitit 1893, organizuar në famullinë e Shkrelit (Malësia e Madhe), me emrin “Bashkimi Shqiptar”, gjykuar nga rëndësia e personave pjesëmarrës, si Doçi, Sarreqi, Dom Dod Koleci, Dom Mark Shllaku, etj, hartimi i platformës së hedhur dhe ngjarjet që pasuan, ishte takimi që ndezi shkëndijën për organizimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve popullore në veri të vendit, për arritjen e momentit të Pavarësisë së vendit.

**Dom Noc Nikaj, ((1865-1951)** romansieri i parë shqiptar, krahas shpërndarjes në popull të librave të tija, botuar në Bruksel, si edhe të pamfleteve “Për Shqipërinë e lirë e vetsunduese”, kishte marrë detyrë për furnizimin me armë të popullatës së Malësisë, nëpërmjet lumit Buna, për çka ishte burgosur dy herë nga Perandoria Osmane, deri sa ishte famullitar në Obot.

Armët vini në rrugë detare, nga Trieste dhe Fijumen dhe dërgoheshin nga Austro-Hungaria, thekson Nikaj në shkrimet e tija, “*Kujtime e nje jete s'kalueme*”.

**Atdhetari, Abat Doçi, (1846-1917)**, letrar dhe diplomat, para krerëve të Mirditës në Orosh, në vitin 1897 kishte paraqitur programin me të cilin parashikonte organizimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve nga 1897-1900 dhe në vazhdim. Në këtë program, sipas konsullit, Theodor Ippeni, të datës 25 qershor 1897, ishte paraparë bashkimin e tri krahinave: Malësisë së Madhe, Dukagjinit dhe Mirditës, nën administrimin e Prek Pashës. Në lidhje me këtë, me 7 dhjetor 1897, kishte raportuar dhe Vjenën.

Duke qenë se Doçi si Abat i një abacie, e cila ishte në rangun e një dioqeze, e kishte të kushtëzuar kthimin në Mirditë, në vitin 1888, nga diplomacia evropiane, për mos angazhimin e tij në politikë, veprimtarinë tij atdhetare u detyrua ta bënte në mënyrë të fshehtë dhe tejet me i rezervuar në raport me çështjen në fjalë.

Doçi, i cilësuar nga diplomacia Austro-Hungareze, si burrë i zgjuar dhe energjik, kishte marrë përsipër që të realizojë bashkimin politik të fiseve shqiptare. Ai që frymëzues i organizimit të kuvendit, të mbajtur gjatë muajit prill në Kimëzë dhe, më vonë, në vitit 1911, në Fan të Mirditës, në të cilin u vendos të kundërshtoheshin hapur sanksionet e ndërmarra kundër popullit, nga Perandoria Osmane.

Doçi në vazhdim që përkrahës i mbajtjes në tetor të vitit 1911, të Kuvendit në Kallmet të Lezhës, ku krerët e 12 bajraqeve të Mirditës vendosën që mos u binden autoriteteve osmane. Gjithashtu Abati, përkrahu dhe nxiti mbajtjen e kuvendit të Rubikut, organizuar po në këtë vit, në të cilën u hartua projekt-kushtetuta për Shqipërinë autonome, e cila në raportet e konsujve, cilësohej si Memorandumi i mirditasve dhe, që u prezantua, nëpërmjet delegacionit mirditor edhe në Besëlidhjen e Shkupit, me 10 gusht 1912. Është i njohur dhe letërkëmbimi i vazhdueshëm i Doçit, me kryetarin e qeverisë së përkohshme të Shqipërisë, Ismail Qemalin nga viti 1903, deri në 1912 dhe më pas, duke menduar për rregullimin e gjendjes, pas shpalljes së pavarësisë së vendit.

**Poeti - Mjeda (1866-1937)** Ëndrrave të popullit liridashës, për t'u çliruar nga zgjedha e vuajtjeve shekullore, nuk kishte si të mos e shqetësonte poetin, Ndre Mjeda. Kthimi i tij në atdhe përkon me riaktivizimin e kryengritjeve kundër Perandorisë Osmane në veri të Shqipërisë. Kur lëvizja shqiptare në malet e Veriut po merrte përpjesëtime të dukshme gjatë aksionit ndëshkues të valiut të Shkodrës, Shaqir Pashës, më dhjetor 1901, Mjeda, si famullitar i Vigut të Mirditës, mori

pjesë aktive krah për krah me Malësorët, në organizimin e kryengritjeve të Mirditës të vitit 1900-1902.

Mjeda, duke kuptuar se çështja e kryengritjeve, duhet të ndërkombëtarizohet, më 26 shkurt 1902, hartoi një memorandum në gjuhët më të rëndësishme, në emër të krerëve mirditorë: (Orosh, Spaç, Kushnin, Fandi, Dibri dhe bajraçet e Pukës të sipërm: Iballja Bugjoni dhe Berisha, e poshtme: Kabashi, Qerreti, Puka dhe Mali i Zi,) dërgon vetë, në dyert e të gjithave konsullatave të akredituara në Shkodër.

Ky veprim i tij, shkaktoi shqetësime, duke e vënë në lëvizje diplomacinë e Perandorisë Osmane në Stamboll, diplomacinë e Vjenës, të Romës dhe të Shkodrës si kryeqendër e ngjarjeve luftarake, duke e cilësuar si një rast të rrallë, që një klerik katolik të merrte guximin dhe, hapur, të qëndronte në ballë të kryengritësve.

Po në të njëjtën kohë, në vitin 1902 ai punoi për ngritjen e shkollës së parë shqipe në Veriun e Shqipërisë, në Iballë të Pukës, shkollë e cila qe një shkëndijë, që më vonë u shndërrua në vullkan, që nxishte kryengritjet.

Për shkak të përfshirjes së tij të vazhdueshme për çështjen kombëtare, Mjeda, qe arrestuar me 11 tetor 1902, në Shkodër, nga valiu Shaqir beu. Pas disa mbledhjeve për këtë problem, mes qeverisë së Stambollit dhe asaj në Vjenë, qeveria turke vendosi lirimin e tij, më 21 tetor 1902, duke urdhëruar poetin të ishte i kujdesshëm dhe mos të merrej më, me politikë.

Mjeda, mori u përfshi gjatë shpërthimeve të kryengritjeve në Malësinë e Mbishkodrës, në vitet 1910-1911, kur ushtria e Turgut Pashës, ushtronte një dhunë të skajshme mbi malësoret. Me këtë rast kërkonte të neutralizonte politikën xhonturke të armatosjes së myslimaneve kundër të krishterëve. Gjithashtu kërkonte që nëpërmjet mbarëvajtjes së të gjitha besimeve, dhe bashkimit në një lëvizje nacionale te vetme, të arrihej tek fitorja e autonomisë për shqiptarët, mundësisht nëpërmjet mënyrave paqësore. Përfshirja në këto ngjare, në natën e 1-2 nëntorit 1912, i solli edhe djegien e shtëpisë si edhe të dorëshkrimet e vyera në qelën e kishës së Kuklit, pas të cilës ai edhe u arrestua nga turqit, për të dytën herë.

Me gjithë dëshirën e madhe për të qenë i pranishëm në çastin e ngritjes së flamurit në Vlorë, më 28 nëntor 1912, Mjeda nuk mundi të marrë pjesë në këtë gëzim mbarëkombëtar për shkak të rrethimit të Shkodrës, në mbarim të nëntorit të vitit 1912, nga malazezët.

### **Flamurtari, dom Nikollë Kaçorri (1868-1917)**

Në vazhdën e lëvizje dhe kryengritjeve në Veri të Shqipërisë, bëjnë pjesë dhe ato të Kurbinit të viteve 1903-1912. Kjo krahinë, si të gjitha viset e tjera, kërkonte të drejtën e vetëqeverisjes.

Pasi në rrethin të Kurbinit, ishte vendosur nga sanxhakbeu i Durrësit, administrata e vijës së ashpër shtetërore turke, qetësia relative në këtë krahinë, do të shndërrohej në lëvizje dhe kryengritje të armatosura, kundër pushtimit osman.

Shkëndijën e parë që e ndezi në zemrat e malësorëve trima të Kurbinit për një kryengritje të përgjithshme kundër Turkut, ishte dom Nikollë Kaçorri.

Kaçorri së bashku me Gjin Pjetrin, udhëheqës, patrioti dhe kurbinas të tjerët, lidhën marrëveshje edhe me malësorët e Mirditës, Lezhës dhe Matit; organizuan për çlirimin nga robëria osmane të këtyre krahinave çeta ushtarake nga viti 1906-1907 dhe në vazhdim. Në vitin 1906, Kaçorri së bashku më Atë Shtjefën Gjeçovin dhe krerët e Kurbinit, në Delbnisht të Gurra e Kurbinit, kishin përpiluar Kanunin e Besëlidhjes prej 12 pikash, i cili do të rregullonte lidhjet e ndërsjella ndërmjet banorëve të vendit. Kjo besëlidhje edhe pse qe kundërshtuar nga kajmekami dhe hoxhallarët e Kurbinit, duke zgjuar ndjenjat vëllavrasëse me baza fetare, qe një mbështetje e mirë për organizimin e mëtejshëm të lëvizjeve dhe kryengritjeve kurbinase në këtë drejtim. Kaçorri, krahas aktivizimit të tij, si delegat i Kongresit të Manastirit, më 1908, Elbasanit dhe, në vitin 1909, atë të Dibrës, kishte marrë përsipër furnizimin me armë të kurbinasve, siguruar nga Perandoria Austro-Hungareze dhe kishte ndihmuar përhapjen e një propagande të gjithanshme për një kryengritje të përgjithshme. Si pasojë e kësaj veprimtarie, me 25 qershor 1910, qe burgosur nga ushtria turke dhe qe dënuar me 4 vjet heqje lirie, me aktakuzën që ngarkonte dhe po u sillte armë kryengritëseve katolikë në Kurbin, dhe po favorizonte kryengritjen e shqiptarëve të Kosovës. Pas ndërhyrjeve të shumta që u bënë nga konsulli Austro-Hungarez, në Shkodër, ai u lirua pas 13 muajsh mbajtje të dënimit.

Por, as vuajtja dhe as dënimi nuk e ndali, atdhetarin Kaçorri. Në qershor të vitit 1912, në luftimet e Lezhës dhe në kryengritjen e Krujës, ai mbajti lidhje të ngushta, me qëllime veprimi, me të gjitha krahinat shqiptare në Veri dhe në Jug të Shqipërisë, si edhe me Sali Nivicën, i cili mbante pseudonimin, Ded Gjoni.

Imzot Kaçorri, njoftonte dhe njoftohej me letra

për kryengritje. Nga Durrësi, më 8 korrik 1912, i shkruan Avdi Bej Toptanit në Skuraj, duke e njoftuar mbi qëndrimin e kryeipeshkvi të Shkodrës Imzot Jak Sarreqit, ndaj kryengritjeve. Më këtë rast Kaçorri, meqenëse ndihej tepër i rrezikuar, për ta ruajtur anonimitetin do të nënshkruajë me pseudonimin “Kunora”.

Në momentet më kulmore për popullin tonë, Nikollë Kaçorri, si nënkryetar i Qeverisë së përkohshme, qëndroi krah për krah me Ismail Qemalin, duke e ngritur flamurin kombëtar, më 28 nëntor 1912, në Vlorë.

Duke qenë se eprori i Kaçorrit, kryeipeshkvi i Durresit, Imzot Preng Bardhi (Bianchi), në mënyrë tërthortë qe bërë pjesë e jetës së kryengritësve, Bardhi, me gëzim të madh e përhapi lajmin në katër anët e Kurbinit për ngritjen e Flamurit Kombëtar dhe në Milot, më 28 nëntor 1912, nga dora e Gjin Pjetrit.

### **Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës dhe kleri katolik**

Pakënaqësia e popullit shqiptar ishte shtuar edhe gjatë kohës xhonturqve, në vitin 1908. Për shkak të masave shtrënguese, malësorët e rretheve të Shkodrës ngritën krye kundër autoriteteve osmane. Për t' i shtypur këto lëvizje, Porta e Lartë së bashku më turqit e rinj, e thelluan dhe me tej politikën e tyre reaksionare antishqiptare, duke organizuar një operacion vdekjeprurës të udhëhequr nga Shefqet Turgut Pasha, i cili nga Kosova në vjeshtë të vitit 1910, qe zhvendosur në Malësinë e Mbishkodrës. Malsia me këtë rast do të provojë vrasje, rrënim të kishave, shtëpive, plaçkitje bagëtish, dijegje të kullosave, etj.

Në këto rrethana, malësorët, të udhëhequr nga prijësit e tyre shpirtërorë: at Karl Prenushi, famullitar i Vuksanlekajve; at Lorenc Mitrovic, i Bajzës; at Mati Prenushi, i Kastratit; at Sebastian Hila, i Rapshës; at Bonaventura Gjeçaj, i Grudës; at Luigj Bushati, famullitar i Traboinit; Dom Nikollë Ashta i Shkrelit, i bënin ballë perandorisë së turbuar.

Momenti më emocionues i këtyre luftimeve qe marrja nga Nikë Gjelosh Luli dhe bashkëluftëtarët e tjerë e fortifikimit të Deçiqit, heqja e flamurit të Turqisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në majën e Bratilës së Deçiqit, me 6 prill 1911.

Me rastin e shpërnguljes së popullatës të paarmatosur, nga Malësia në Podgoricë, për shkak të spastrimeve turke, për ngritje në këmbë të diplomacisë evropiane, u përfshinë, kryeipeshkvi i Shkodrës, Imzot Jak Serreqi, së bashku me abat

Doçin, Atë Gjergj Fishtë, Dom Luigj Bumçin, Dom Ndre Mjedën.

Meqenëse qeveria turke, duke e ruajtur gjendjen “Status Quos” (gjendje të pandryshueshme), nuk i plotësoi kërkesat e Kuvendit të Gërçës të 10-25 qershor 1911, shqiptarët vazhduan kryengritjet në ndërprerje, gjatë vitit 1912, deri në pikën kulmore, kur me ndihmën e Austro-Hungarisë, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, dom Nikollë Kaçorri dhe të tjerët, në Vlorë, më 28 nëntor 1912, shpallën Pavarësinë e Shqipërisë. Për këtë ngjarje, i mallëngjyer ishte dhe kryeipeshkvi i Shkupit, Imzot Lazër Mjeda, i cili duke u gjetur për bisedime zyrtare në Vjenë, ndihmoi financiarisht, udhëtimin me vapor nga Vjena për në Durrës, për Luigj Gurakuqin dhe Ismail Qemalin.

### **Përfundimi**

Perandoria Austro-Hungareze, në kuadër Protektoratit të Kultit (Program Veprimi, - Ballhausplatz-in), përveç ndihmesës, qe çmuar në organizimin e kryengritjeve, çka solli edhe shpalljen e Pavarësisë. Ajo kishte ofruar, pa masë në fushën e edukimit dhe të arsimimit, duke ndihmuar në botime të librave shkollorë, revistave, si Elçja e “Zemrës së Krishtit”, “Hylli i Dritës”, “Posta e Shqipërisë”, “Zani i Shna Ndout,” si edhe në shumë botime të tjera. Në këtë kuadër, nxënësit, nga Shqipëria, dërgoheshin për studime të larta në filozofi dhe në teologji, si dhe në fusha të tjera, në qytete austriake: Vjenë, Insbruck, Linz, Grac, Villach, etj., duke u specializuar në teologji, albanologji, linguistikë, histori, arkeologji, në shkencat e sakta: fizikë, kimi, mjekësi, muzikë etj. Kjo skemë ndihmesë do të vazhdonte të funksiononte deri në vitin 1918.

Në fushën e politikës, ajo përveç se qe protagonistja kryesore i arritjes dhe e shpalljes së Pavarësisë, qe shumë aktive, dhe pas saj, kur shtetet e porsakrijuara, zgjeronin hapësirat e tyre territoriale në tokat shqiptare; si dhe qe zëri i fuqishëm i shqiptarëve në Konferencën Ndërkombëtare, të Londrës, më 1913 dhe atë të Parisit, më 1919. Në lidhje me këtë, ajo pati një aleat të fuqishëm, klerin katolik, cili duke soditur thënien se, populli që nuk e gëzonte lirinë, nuk e gëzonte as jetën, veptoi me përkushtim, sipas motos, Për Zot, Atme e Përparim.

Prandaj, Shqipëria, falë ndihmës së dhëne nga kjo Perandori dhe klerit katolik, arriti të bëhej e dallueshme si një entitet i veçantë kombëtar, kulturore dhe gjeopolitik, në skenën e diplomacisë evropiane.

# PËRKUJTOHET POETI MJEDA NË 100 VJETORIN E PAVARËSISË

Mjeda u lind, 20 nëntor 1866 në Shkodër, vdiq me 1 gusht 1937.



Në kuadër të kremtimit të 100 vjetorit të Pavarësisë dhe shtetit shqiptar, Komuna e Bushatit dhe Qendra e Muzeore Ndre Mjeda, organizuan në Kukël, me 20 nëntor, të këtij viti ditën përkujtimore të lindjes së poetit Mjeda.

Në këtë manifestim morën pjesë, përpos autoriteteve të komunës së Bushatit dhe Qendrës Muzeore si Dom Nikë Ukgjini e Mentor Quku, dhe personalitetet të larta fetare, kulturore dhe politike të qytetit të Shkodrës.

Në fillim, u vunë lule të freskëta të shtatorja e Mjedës, duke e kujtuar në 146 vjetorin e lindjes së tij, dhe kontributin e dhënë në 100 vjetorin e Pavarësisë. Fjalën përshëndetëse e mbajti kryetari i Komunës së Bushatit Zef Hila, i cili më fjalë të zgjedhura të vitit jubilar përshëndeti, mysafiret të nderuar: kryetarin e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Imzot Angelo Massafra, ambasadorin e Britanisë së Madhe, z. Nicholas Cannon, konsullin e Nderit të Austrisë, Gjergj Lejçezja, deputetin Gjokë Uldedaj, si dhe mësuesit dhe nxënësit e shkollave të mesme të kësaj komune, të cilët ishin bashkuar në një numër të madh për këtë kremtim të veçantë. Më pas fjalën e mori Imzot Angelo Massafra i cili shpallosi, porosinë e letrës baritore të ipeshkvijve shqiptarë më rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, ndërsa, ambasadori Cannon, shprehu kënaqësinë që pati rastin për t'i vizituar këto ambiente të poetit më përmasa ndërkombëtare Ndre Mjeda. Fjalën e morën edhe mysafiret të tjerë të pranishëm.

Në vazhdim të pranishmit, vizituan, kishën e poetit Mjeda të ndërtuar në vitin 1913 si dhe shtëpinë muze të themeluar që në vitin 1962 e cila pret restaurimin e plotë të saj si dhe tryeza 100 vjeçare e Mjedës e cila akoma gjendet në depot e muzeut të Shkodrës.


Manifestimi u shoqërua me këngë e valle dhe recitime të ekzekutuar nga fëmijët e shkollave të komunës së Bushatit.

*Marrë nga gazeta:  
Panorama, 21 nëntor 2012.*





Angjelin Shtjefni  
Nikollë Loka  
**IMZOT NIKOLLË KAÇORRI**  
EUGEN, Tiranë 2012



Xhevat Lloshi  
**PËRKTHIMI (DHIATES SÁ RE)  
I V.MEKSIT DHE REDAKTIMI  
I  
G. GJIROKASTRIT  
1819-1927**  
ONUFRI, Tiranë 2012



Tonin Çobani  
**LAHUTA E MALCIS**  
GJERGJ FISHTA, Lezhë 2012

**KUMBONA E SÁ DIELÁS**  
revistë fetaro-kulturore dymujore  
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult  
Tirazhi: 1000 kopje  
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)  
Parapagimi vjetor 600 lekë  
(Evropë: 12 Euro)  
e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it  
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com  
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,  
Sheshi -Gjon Pali II"  
Shtypur në Entin Botues -Gjergj Fishta" - Lezhë